



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS**

**RAPORTI VJETOR 2016**

*Sfidat e Institucionit për vitin 2017*



<b>HYRJE</b> .....	<b>8</b>
--------------------	----------

<b>FJALA E KRYETARIT TË KOMISIONIT TË AUTORITETIT TË KONKURENCËS</b> .....	<b>10</b>
--	-----------

## **PJESA E PARË**

<b>DREJTIMET KRYESORE TË POLITIKAVE TË KONKURENCËS DHE MIRATIMI I NJË KUADRI LIGJOR SEKONNDAR, NË FUNKSION TË ZBATIMIT TË LIGJIT “PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS”</b> .....	<b>12</b>
--	-----------

1.1 Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe përcaktimi i drejtimeve kryesore të politikës së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2016. ....	12
---	----

1.2 Legjislacioni sekondar - Rregulloret e reja të miratuara gjatë vitit 2016.....	13
--	----

## **PJESA E DYTË**

<b>ZBATIMI I LIGJIT TË KONKURENCËS DHE POLITIKAVE TË KONKURENCËS</b> .....	<b>16</b>
--	-----------

2.1 Marrëveshjet e ndaluara dhe abuzimi me pozitën dominuese – tregjet e monitoruara dhe të hetuara. ....	16
---	----

2.2 Tregjet e monitoruara. ....	17
---------------------------------	----

2.3 Hetimet për marrëveshjet e ndaluara dhe pozitën dominuese.....	21
--	----

2.4 Përjashtim nga ndalimi i marrëveshjeve.....	31
---	----

2.4.1 Statistika në lidhje me përjashtimin nga ndalimi i marrëveshjeve. ....	32
--	----

2.4.2 Përshkrimi i rasteve specifike. ....	32
--	----

2.5 Kontrolli i përqendrimeve.....	34
------------------------------------	----

2.6 Përqendrimet e autorizuara dhe statistika në lidhje me përqendrimet e autorizuara.....	35
--	----

2.6.1 Përfitim kontrolli (i drejtpërdrejtë ose i tërthortë) i një ose më shumë ndërmarrjeve ose i një pjese të kësaj të fundit - Rastet specifike të përfitimit të kontrollit. ....	36
---	----

2.7 Mosmiratimi i përqendrimeve – rastet specifike. ....	37
--	----

2.8 Raste të shqyrtuara që nuk janë konsideruar objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.....	38
---	----

2.9 Rishikimi i të drejtave ekskluzive. ....	42
--	----

2.9.1 Statistika në vite në lidhje me rishikimin e të drejtave ekskluzive. ....	43
---	----

2.9.2 Përshkrimi i rasteve për dhënien e të drejtës ekskluzive. ....	43
--	----

## **PJESA E TRETË**

<b>AUTORITETI I KONKURENCËS PËRBALLË PROCESIVE GJYQËSORE</b> .....	<b>46</b>
--	-----------

3.1 Statistika në lidhje me çështjet gjyqësore në 3 shkallët e gjyqësorit.....	47
--	----

3.2 Çështje në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.....	47
---	----

3.3 Çështje në Gjykatën Administrative të Apelit. ....	47
--	----

3.4 Çështje në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. ....	50
--	----

## **PJESA E KATËRT**

### **ROLI I AUTORITETIT TË KONKURENCËS NË FORMULIMIN DHE IMPLEMENTIMIN E POLITIKAVE TË TJERA – ADVOKACIA E KONKURENCËS..... 54**

- 4.1 Vlerësimi i akteve dhe projekt-akteve normative. .... 54
- 4.2 Rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës. .... 58
- 4.3 Transparenca dhe marrëdhëniet publike në funksion të advokacisë së ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. .... 60

## **PJESA E PESTË**

### **INTEGRIMI EUROPIAN DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR..... 62**

- 5.1 Integrimi evropian ..... 62
- 5.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar ..... 62
- 5.3 Bashkëpunime dypalëshe ..... 64

## **PJESA E GJASHTË**

### **BURIMET NJERËZORE ..... 66**

- 6.1 Struktura organizative e Autoritetit të Konkurrencës..... 66
- 6.2 Të dhëna statistikore për trajnimin e stafit të AK-së ..... 66

# **3**

## **PJESA E SHTATË**

### **OBJEKTIVAT DHE PËRAFRIMI INSTITUCIONAL ME STANDARTET DHE PRAKTIKAT E BE-së . 68**

- 7.1 Objektivat e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2017..... 68
- 7.2 Përafrimi institucional me standardet dhe praktikat e BE-së..... 68

### **ANEKSE ..... 70**

- Aneksi 1 – Të dhëna statistikore mbi vendimet e Komisionit të Konkurrencës sipas viteve. .... 70
- Aneksi 2 - Sektorët e ekonomisë ku janë realizuar përqëndrimet për periudhën 2012-2016..... 71
- Aneksi 3 – Vendimet e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2016. .... 72
- Aneksi 4 – Buxheti faktik i Autoritetit të Konkurrencës viti 2016. .... 76
- Aneksi 5 - Të ardhura nga përqendrimet shkuar në Buxhetin e Shtetit. .... 76

## Listë shkurtimesh

<b>AK</b>	Autoriteti i Konkurrencës
<b>AKEP</b>	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
<b>AMA</b>	Autoriteti i Mediave Audiovizive
<b>AMF</b>	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
<b>APP</b>	Agjencia e Prokurimit Publik
<b>BE</b>	Bashkimi European
<b>BSH</b>	Banka e Shqipërisë
<b>DPT</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
<b>ERE</b>	Enti Rregullator i Energjisë
<b>FSDKSH</b>	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
<b>H index</b>	Indeksi i përqendrimit Herfindal
<b>ICN</b>	Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës
<b>IPA</b>	Instrumenti i Para-Zgjerimit i BE-së
<b>KE</b>	Komisioni European
<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>Ligji nr. 9121/2003</b>	Ligji nr. 9121 datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar
<b>MSA</b>	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
<b>ROA</b>	Kthimi ndaj asetëve
<b>ROE</b>	Kthimi ndaj kapitalit
<b>RSH</b>	Republika e Shqipërisë
<b>TAIEX</b>	Asistenca Teknike dhe Shkëmbimi Informacionit e BE-së
<b>UNCTAD</b>	Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin



## **30 sek.' Ç'është konkurrenca**

**“Telefonia celulare, gazi dhe nafta, standardizimi, certifikimi, transporti, produktet e qumështit, aparatet dhe medikamentet farmaceutike, janë tregje në KONKURRENCË, profesionet e lira, hoteleri turizëm, tregu i sigurimeve, tregu energjisë, rregullimi NË sistemin bankar, peshkimi, produktet blegtorale dhe bujqësore, zyrat e pasurive të paluajtshme, GJITHÇKA, tregu i mediave audiovizive, prokurimet publike ”**





## HYRJE

### ASPEKTE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK PËR VITIN 2016 DHE ROLI AUTORITETIT TË KONKURRENCËS

Viti 2016, mund të konsiderohet si viti i konsolidimit të ekonomisë shqiptare, e cila duket se ka hyrë tashmë në një trajektore të rritjes.

Fondi Monetar Ndërkombëtar<sup>1</sup>, ka vlerësuar se rritja e Produktit të Brendshëm Bruto pritet të ketë arritur në 3,4%, në vitin 2016 dhe parashikohet të përshpejtohet në rreth 4 %, në periudhë afatmesme, e mbështetur kryesisht tek investimet e mëdha të huaja direkte, të lidhura me energjetikën dhe te një rritje e kërkesës së brendshme.

Sinjal të rëndësishëm përbën shfaqja e trendit pozitiv të konsumit për të katërtin tremujor rradhazi, që prej tremujorit të tretë të vitit 2015. Në gjysmën e parë të vitit 2016, konsumi regjistroi një rritje reale prej 3.1% nga një kontraktim i lehtë vjetor prej 0.7%, për vitin 2015.<sup>2</sup>

Gjithashtu edhe investimet kanë vijuar të regjistrojnë ritme relativisht të larta, të vëna re që prej tremujorit të parë të vitit 2015, ndonëse në gjysmën e parë të 2016, këto ritme të rritjes u ngadalësuan disi, përgjithësisht si rrjedhojë e uljes së investimeve në **industrinë nxjerrëse**, e lidhur kjo me konjunkturën e **çmimeve të karburanteve**. Investimet, për gjysmën e parë të 2016, u rritën me 6.2% në terma realë nga një rritje prej 12.5%, regjistruar në vitin 2015 në tërësi.

Nga optika e ofertës, kontributin kryesor në rritjen e gjysmës së parë të vitit 2016 e dhanë degët: **tregti, hotele dhe restorante** si dhe **transporti**, me rritje reale 5.4% dhe kontribut 0.8 pikë përqindje; **industria përpunuese** me rritje 6.8% dhe kontribut 0.4 pikë përqindje; ndërtimi me rritje 4.4% dhe kontribut 0.4 pikë përqindje; si dhe **informacioni dhe komunikacioni** me rritje 12.1% dhe kontribut 0.3 pikë përqindje. Ndërkohë, rritje dhe kontribut negativ, për gjysmën e parë të 2016 kishin degët e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit, si dhe industria nxjerrëse.

Treguesi i Ndjesisë Ekonomike (TNE) apo besimi i biznesit dhe konsumatorit në ekonomi, që në tremujorin e katërt 2016, shënoi një rritje prej 9.4 pikë përqindje dhe një kapërcim prej 18.6 pikë përqindje mbi mesataren historike afatgjatë, niveli më i lartë i besimit në ekonomi, në 10 vitet e fundit.

Edhe në aspektin e **investimeve të huaja direkte**, ekonomia ka shënuar një tjetër rritje pozitive, bazuar në vlerësimet e Bankës Botërore, me 9% të PBB duke u renditur të dytët në rajon, pas Malit të Zi.

<sup>1</sup> <http://www.imf.org/external/lang/albanian/np/sec/pr/2017/pr1717a.pdf>

<sup>2</sup> Ministria e Financave, *Relacion "Mbi projektligjin "Për buxhetin e vitit 2017"*, e vlefshme në <https://www.parlament.al>

Në tremujorin e tretë 2016, sipas Bankës së Shqipërisë, investimet e huaja direkte shënuan një rritje me 13%, krahasuar me një vit më parë ose thënë në vlerë, 288 milionë euro.

Së fundi, gjatë vitit të kaluar Shqipëria u rikthye sërish **një vend eksportues neto i energjisë elektrike**, për herë të parë pas 6 vjetësh. Sipas raportimeve zyrtare të KESH, vitin e kaluar u eksportuan rreth 700 milionë kilovat orë energji në vendet e tjera, si rezultat i përmirësimit të ndjeshëm të bilancit energjetik, falë rritjes së prodhimit vendas dhe uljes së ndjeshme të abuzimeve në rrjet.

Ky trend i zhvillimit ekonomik, pa dyshim kërkon edhe respektimin e rregullave të konkurrencës, bazuar në një konkurrencë të lirë dhe efektive, ku Autoriteti i Konkurrencës (këtu e në vazhdim AK) , luan rolin e tij primar, si rregullator dhe mbikëqyrës i zbatimit të ligjit nr.9121/2003, për të siguruar një ekonomi tregu funksionale.

Viti që lamë pas, në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit u shoqërua me një veprimtari aktive të AK-së, ku ndër më domethënëset, do të përmendim:

1. Monitorimin, hetimin dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse në tregje kryesore dhe sensitive të ekonomisë shqiptare, me impakt të drejtpërdrejtë te konsumatori shqiptar, përkatësisht:
  - Tregun farmaceutik;
  - Tregun e grumbullimit të duhanit të papërpunuar;
  - Tregun e prokurimit publik për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike;
  - Tregun e produkteve të qumështit dhe nënprodukteve të tij;
  - Tregun e furnizimit me karburant në zonën gjeografike të aeroportit;
  - Sektorin bankar.
2. Bashkëpunimin me autoritete të tjera rregullatore dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse:
  - Në tregun e prokurimit publik;
  - Në tregun e qirasë financiare;
  - Në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik.
3. Rolin potencial të AK-së në dhënien paraprake të vlerësimeve ligjore për çdo projekt-akt normativ, që ka si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizime sasiore apo cilësore të konkurrencës në tregje, ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë, përkatësisht:
  - Draft-kontratën kocensionare “Partneriteti publik-privat i formës ROT për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e infrastrukturës hekurudhore Fier-Ballsh, Fier-Vlorë”;
  - Kodin Hekurudhor të Republikës së Shqipërisë;
  - Modelin e tregut të energjisë elektrike;
  - Udhëzimin mbi rregullat në vendosjen e tarifave të aeroportit.

## FJALA E KRYETARIT TË KOMISIONIT TË AUTORITETIT TË KONKURENCËS

“Konkurrenca nuk shërben vetëm si bazë për mbrojtjen e konsumatorëve; ajo është stimul për vetë progresin” - Herbert Hoover

Viti 2016, ishte një vit kompleks ku sfidat për rigjallërim të shpejtë të ekonomisë botërore hasën në zhvillime të paparashikuara politike, ekonomike financiare dhe sociale. Pas përfundimit të tij, kanë dalë analizat e para të cilat theksojnë se 2016 do të kujtohet për: rritjen e pabarazisë sociale e cila i ka hapur dyert rritjes së populizmit politik; daljen e Britanisë së Bashkuar nga Bashkimi Europian ose siç njihet ndryshe me termin BREXIT; rritjen e pasigurisë globale dhe krizën e refugjatëve; rritjen e protagonizimit të Ruisë në arenën ndërkombëtare; rritjen e plogët dhe paqëndrueshmërinë e tregjeve; planin ambicioz të reformave të shpallura nga Kina.

Në planin e brendshëm viti i kaluar do të përmendet për përpjekjet e gjithanshme të cilat kulmuan me miratimin konsensual nga ana e Kuvendit të Shqipërisë së reformës në drejtësi në muajin korrik 2016. Miratimi i kësaj reforme vlerësohet maksimalisht edhe nga Autoriteti i Konkurrencës, pasi zbatimi i saj do të rrisë më tej shanset për të imponuar në treg lojë më të ndershme ku shpirti i lirë i sipërmarrjes i kombinuar me një konkurrencë të lirë do të garantojë më shumë prosperitet dhe zhvillim.

Duke vlerësuar ecurinë e ekonomisë në përgjithësi, viti 2016 u karakterizua nga një gjallërim i mëtëjshëm i aktivitetit ekonomik. Ndërkohë falë dhe përpjekjeve dhe kontributit të Autoritetit, efektiviteti i tregjeve ka ardhur në rritje duke garantuar një shpërndarje resursesh financiare dhe të mirash materiale më të njëtrajtshme dhe më gjithëpërfshirëse. Aktiviteti i Autoritetit të Konkurrencës për gjatë gjithë vitit ka qenë i orientuar në përmbushje të misionit kryesor ligjor: “për sigurimin e një konkurrence të lirë dhe efektive në treg”.

Fokusi i veprimtarisë së Autoritetit ka qenë jo vetëm monitorimi, analizimi, dhe evidentimi i situatave të paqarta dhe të dyshimta por edhe propozimi i masave dhe rekomandimeve konkrete për kapërcimin e tyre. Moto jonë institucionale përgjatë gjithë vitit të kaluar ishte se nxitja dhe mbrojtja e konkurrencës së lirë mbi gjithçka i shërben interesave të konsumatorit të thjeshtë dhe prosperitetit ekonomik dhe social afatgjatë të vendit.

Qëllimi ynë ndërmjet të tjerash synoi shndërrimin tonë në një burim idesh për të ndihmuar autoritetet vendimmarrëse në identifikimin dhe hartimin e reformave strukturore, për të mundësuar në këtë mënyrë çlirimin e potencialeve të fjetura për inovacion dhe rritje të qëndrueshme. Në vazhdë me traditat më të mira ndërkombëtare Autoriteti i Konkurrencës i kushtoi vëmendje të veçantë identifikimit dhe analizimit në detaje të çështjeve specifike të cilat vlerësohen se kanë rëndësi sistematike. Ne besojmë se adresimi me shpejtësi i gjetjeve dhe rekomandimeve tona do të çojë në përmirësime thelbësore të rëndësishme të degës, të sektorit, apo të politikës ekonomike; pse jo të një apo disave njëkohësisht.

Nga një këndvështrim institucional fundi i vitit 2016 përkon me zgjedhjen nga ana e Kuvendit të Kryetarit të ri të Autoritetit të Konkurrencës pas përfundimit të mandatit të kryetarit të mëparshëm. Për këtë qëllim në axhendën e veprimtarisë së Autoritetit për vitin 2017, janë përfshirë një sërë objektivash institucionale të cilët përveç përmirësimit të qeverisjes së

Autoritetit do të mundësojnë dhe forcimin e rolit të Autoritetit në kapacitetin e tij analizues, këshillues dhe penalizues.

Rishikimi i ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, rishikimi i bazës nënligjore dhe i strukturës organizative të institucionit vlerësohen prioritare për vitin 2017. Përshtatja e tyre me sfidat e kohës dhe përputhshmëria me frymën e BE do të jenë drejtimet ku do të ndalemi më konkretisht.

Në emër të Autoritetit të Konkurrencës dëshiroj të garantoj Kuvendin e Shqipërisë se veprimtaria e tij do të jetë në frymën e ligjit në rezonancë të plotë me objektivat kombëtare për zhvillimin ekonomik financiar të qëndrueshëm të vendit dhe përafrimin e pandërprerë me Bashkimin Europian.

## PJESA E PARË

### DREJTIMET KRYESORE TË POLITIKAVE TË KONKURRENCËS DHE MIRATIMI I NJË KUADRI LIGJOR SEKONДАР, NË FUNKSION TË ZBATIMIT TË LIGJIT “PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS”

#### 1.1 Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe përcaktimi i drejtimeve kryesore të politikës së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2016.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet rezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2015”, datë 19.05.2016<sup>3</sup>, e cila përbën një akt ligjor të detyrueshëm për veprimtarinë e AK-së, parashtroi drejtimet kryesore të politikës së konkurrencës për vitin 2016, drejtime të cilat përcaktuan edhe ndërmarrjen e hapave konkretë në funksion të përmbushjes së misionit të AK-së, për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg.

Gjatë vitit 2016, AK në zbatim të kësaj Rezolute, përcaktoi dhe zbatoi si politika të tij:

1. Përmirësimin e punës në drejtim të ndërhyrjeve të vazhdueshme, sidomos në ato tregje, nga të cilat numri i ankesave nga aktorët ishte më i lartë dhe me ankesa të përsëritura çdo vit, për pretendime të sjelljeve abuzive në treg.
2. Përmirësimin e instrumenteve hetimore, sidomos për inspektimet e befasishme, për të siguruar evidenca apo prova të mjaftueshme në rastet e karteleve.
3. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjeve që iu janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive dhe të veçanta, duke dhënë rast pas rasti rekomandimet përkatëse.
4. Thellimin e monitorimeve dhe hetimit në tregjet ku janë shfaqur kufizime, pengime apo shtrembërime të konkurrencës, duke dhënë rast pas rasti mënyrat e rivendosjes së konkurrencës në tregjet përkatëse apo rekomandimet për institucionet qendrore dhe entet rregullatore.
5. Forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative, nëpërmjet trajnimeve të inspektorëve, me qëllim rritjen e ekspertizës jo vetëm për hetimet, por edhe për analizat e thelluara ekonomike, për të identifikuar sjelljen e ndërmarrjeve në treg.
6. Rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për politikën anti-kartel, nëpërmjet aktiviteteve me të tretët dhe fushatave informuese adresuar bizneseve, lidhur edhe me përfitimet që vijnë si rezultat i pjesëmarrjes në programin e lehtësimit nga gjokat.

<sup>3</sup> Rezolutë, nr.3 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2015”. [2015] FZ nr.102.

7. Koordinimin me entet shtetërore, për të garantuar më tepër konkurrencë në prokurimet publike dhe ndjekjen e rekomandimeve të dhëna në rastet e marrëveshjeve në oferta.
8. Rolin aktiv, nëpërmjet dhënies paraprakisht të vlerësimeve ligjore, për çdo projekt-akt normativ, që ka si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizime sasiore apo cilësore të konkurrencës në tregje ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë.
9. Ndjekjen me rigozitet të proceseve gjyqësore dhe ekzekutimit të gjobave, për mirëfunksionimin e ligjit nr. 9121/2003.
10. Bashkëpunimin e vazhdueshëm me Shkollën e Magjistraturës, për trajnimin e gjyqtarëve, për një njohje sa më të plotë dhe adekuate të veçorive të ligjit të konkurrencës, si dhe të së drejtës europiane në këtë fushë, me synim arsyetimin e vendimeve të tyre, bazuar në një vlerësim real të konkurrencës, si një e mirë publike.

## 1.2 Legjislacioni sekondar - Rregulloret e reja të miratuara gjatë vitit 2016.

AK në zbatim të neneve 70, 71 dhe 72 të MSA-së, sipas të cilit është parashikuar detyrimi dhe angazhimi që ka Shteti Shqiptar për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë europian, përgjatë vitit 2016 ka vijuar këtë proces, duke synuar që kuadri ligjor në fushën e konkurrencës, të shkojë gradualisht drejt përafrimit të plotë me legjislacionin europian .

AK e konsideron shumë të rëndësishëm, jo vetëm procesin e përafrimit të këtij legjislacioni, por edhe shkallën e zbatueshmërisë së rregullave dhe dispozitave përkatëse.

Aktet e miratuara, në nivel sekondar nga Komisioni i Konkurrencës gjatë vitit 2016, kanë synuar zbatimin e drejtimeve kryesore të politikave të konkurrencës, me qëllim që ato t'i vijnë në ndihmë dhe të lehtësojnë procedurat dhe kohëzgjatjen e tyre në sektorin e biznesit.

Në zbatim të ligjit nr. 9121/2003, është miratuar rregullorja nr. 437, datë 05.10.2016 "**Mbi procedurat e angazhimeve**"<sup>4</sup>, me objekt përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që zbatohen në rastet e përfundimit dhe mbylljes së procedurave hetimore, nëpërmjet vendimeve me angazhime.

Nëpërmjet kësaj rregulloreje, synohet të normohet veprimtaria e biznesit, kur ai ndodhet përpara sjelljes së dyshimtë. Vendimet me angazhime, paraqesin angazhime të ofruara nga

<sup>4</sup> Rregullorja e Këshillit [EC] nr. 1/2003 e datës 16 dhjetor 2002, mbi implementimin e rregullave të konkurrencës sipas neneve 81 dhe 82 të Traktatit (*OJ L 1, 4.1.2003, p. 1–25*)(32003R0001) (neni 9); Manuali i Procedurave, (Mars 2012); Njoftimi i Komisionit mbi praktikat më të mira për procedurat sipas neneve 101 dhe 102 të TFEU (2011/C 308/06).

vetë ndërmarrjet, të cilat janë detyruese për to, krijojnë siguri ligjore, rivendosin konkurrencën në treg dhe sigurojnë ruajtjen efektive të saj në mënyrë të vazhdueshme.

Vendimet me angazhime i kthejnë angazhimet në formë ligjore dhe konkludojnë që nuk ka më nevojë për hetime të mëtejshme nga ana e AK-së.

Nëpërmjet një vendimi me angazhime, nuk synohet vendosja e sanksioneve administrative, por i jepet fund sjelljes së dyshimtë, duke vendosur mbi ndërmarrjet kushtet që adresojnë shqetësimet e ngritura.

Një akt i tillë nënligjor është pranuar nga komuniteti i biznesit dhe është pjesë e shumë autoriteteve homologe europiane dhe nga zbatimi i tij, ka pasur një ndikim pozitiv dhe të menjëhershëm në treg.

Nëpërmjet kësaj procedure, kemi përftime të dyanshme, ndërmarrjet reduktojnë kostot e tyre financiare në rastet e zbulimit të një shkeljeje, ndërsa AK ia dedikon kohën dhe burimet njerëzore, hetimit të një rasti tjetër anti-konkurreus.

### Skema e realizimit të angazhimit

TABELA 1



Udhëzimi nr. 419, datë 08.06.2016 “Për procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”<sup>5</sup>, synon të ofrojë mënyra lehtësimi dhe afate kohore të shkurtuara, për disa lloj përqendrimesh, të cilat nuk sjellin pengim, kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në treg. Udhëzimi, bazuar në natyrën e përqendrimit, nuk kërkon analiza të detajuara, lehtëson ndërmarrjet nga sigurimi i informacioneve të detajuara dhe Komisioni i Konkurrencës autorizon përqendrimin, pa kryer hetime të mëtejshme dhe analiza të mirëfillta ekonomike.

Udhëzimi, është një akt i tillë nënligjor, me fushë veprimi të konsiderueshme edhe në autoritetet e tjera homologe, për vetë shkurtimin e afateve kohore dhe zgjidhjen e shpejtë në dhënien e autorizimit për mirë funksionimin e ndërmarrjes që përqendrohet.

<sup>5</sup> Njoftimi i Komisionit mbi procedurat e thjeshtuara në trajtimin e disa përqendrimeve, sipas rregullores së Këshillit [EC] nr. 139/2004 (52013XC1214(02) (2013/C 366/04).





## PJESA E DYTË

### ZBATIMI I LIGJIT TË KONKURENCËS DHE POLITIKAVE TË KONKURENCËS


#### 2.1 Marrëveshjet e ndaluara dhe abuzimi me pozitën dominuese – tregjet e monitoruara dhe të hetuara.

Ligji nr. 9121/2003 përafuar me *acquis* të BE-së, ka si qëllim kryesor mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, duke përcaktuar rregullat e sjelljes në treg, kundër praktikave antikonkurrense, që konsistojnë në marrëveshje të ndaluara apo abuzim me pozitën dominuese të një ose disa ndërmarrjeve në treg.

Numri i praktikave të hetuara dhe vlerësuara nga AK në vite ka ardhur në rritje, duke arritur kulmin në vitin 2014 me 10 raste (marrëveshje dhe abuzim me pozitën dominuese) ndërkohë që për vitin 2016, janë ndjekur procedurat për 6 raste.

#### Procedurat hetimore për marrëveshjet e ndaluara dhe abuzim me pozitën dominuese në vite.

TABELA 2




Sektorët dhe tregjet kryesore të ekonomisë ku ka monitoruar dhe hetuar, dhe është shprehur me rekomandime AK, për vitin 2016, janë kryesisht tregjet financiare, si hetimi i përgjithshëm në sektorin bankar dhe hetimi paraprak dhe i thelluar në tregun e sigurimeve të detyrueshme motorike; tregu i produkteve shëndetësore (insulina); grumbullimi dhe shitja e duhanit të

papërpunuar; prokurimet publike; agroindustria (qumështi dhe nënproduktet e tij); si dhe furnizimi me karburant i avionëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës.

### Tregjet kryesore të ekonomisë të monitoruara dhe hetuara për 2016

TABELA 3



## 2.2 Tregjet e monitoruara.

17

### i. Monitorimi në tregun e mediave audiovizive

Kryerja e këtij monitorimi u realizua pas ankesave të ardhura pranë AK-së nga ana e ndërmarrjeve TRING TV, ABCOM si edhe e Shoqatës së Operatorëve Kabllorë.

Sekretariati, bazuar në nenin 28, germa a, të ligjit nr. 9121/2003, nisi procedurën e monitorimit në tregun e mediave audiovizive për vlerësimin e marrëveshjes së ekskluzivitetit, për ndërmarrjen Digitalb SHA që kërkonte përjashtim nga marrëveshja në bazë të nenit 5, të ligjit nr. 9121/2003 dhe udhëzimit “Për vlerësimin e marrëveshjeve vertikale”.

Nga vlerësimi i kontratave të aplikuara nga ndërmarrja Digitalb SHA, nga AK, u vlerësua: se ato janë një e drejtë kontraktuale e palëve në marrëdhëniet tregtare dhe mosmarrëveshjet që lindin nga këto kontrata, mund të zgjidhen në bazë të Kodit Civil dhe akteve të tjera ligjore në fuqi, duke mos rënë ndesh me nenet 4, 5 dhe 9, të ligjit nr. 9121/2003.

### ii. Monitorimi në tregun e shërbimit të certifikim-inspektimit të transportit të karburanteve dhe lëndëve të rrezikshme.

Pranë AK-së, me anë të formularit të ankimit nr. 112 Prot., datë 10.03.2016, është paraqitur informacioni mbi ndërmarrjen “Almeta GMBH” SHPK dhe “EL BU 2009” SHPK, të cilat sipas ankimesit, kryejnë një aktivitet në fushën e certifikimit të automjeteve që merren me transport të karburanteve, mallra të cilët vlerësohen si të rrezikshme.

Nga realizimi i procedurës së monitorimit dhe nga vlerësimi i të dhënave të sjella nga ana e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, u konstatua se janë 3 ndërmarrje që operojnë në fushën e shërbimit të inspektim-certifikimit të mjeteve që transportojnë lëndë të rrezikshme (ADR), "Almeta" SHPK, "Auto tekno test" SHPK, "ORLU" SHPK, si edhe tregu është i hapur për hyrje të reja për të gjitha ato subjekte, që plotësojnë kriteret për t'u licencuar.

Si konkluzion, për sa më sipër në vlerësim të neneve 8 dhe 9, të ligjit nr. 9121/2003, u konstatua se ndërmarrjet "Almeta GmbH" SHPK dhe EL-BU 2009 SHPK, nuk janë të vetme në shërbimet përkatëse të inspektim-certifikimit që ato realizojnë, në bazë të licencave që disponojnë.

Tregu rezultoi se nuk kishte barriera ligjore hyrëse dhe ndërmarrjet që operojnë në transportin e mallrave të rrezikshëm përballen me çmime konkurruese, për sa i përket shërbimit të inspektim-certifikimit ADR.

*iii. Monitorimi në tregun e prokurimit publik me objekt "Blerjen e pajisjeve dhe sigurimin e shërbimeve që përfshihen në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, për periudhën 2014 – 2015".*

Sekretariati, gjatë vitit 2016 realizoi procedurën e monitorimit në tregun e prokurimit publik me objekt "Blerjen e pajisjeve dhe sigurimin e shërbimeve që përfshihen në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për periudhën 2014 – 2015".

Në vijim të procedurës së monitorimit është administruar i gjithë informacioni mbi procedurat e prokurimit publik me objektin e monitorimit nga faqja zyrtare e APP-së.

Në përfundim, nga vlerësimi i materialeve të administruara gjatë procedurës së monitorimit u konstatua se:

- Numri i operatorëve ekonomikë, që merrnin pjesë në procedurat e prokurimit në tregun përkatës është relativisht i madh duke ulur mundësinë e marrëveshjeve të ndaluara në oferta.
- Ofertat e paraqitura nga operatorët ofertues në këto procedura prokurimi publik, varionin nga 63 % deri në 90 % të fondit limit.
- Nga shqyrtimi i procedurave të prokurimit publik për vitet 2014 – 2015, nuk u konstatuan skema të ofertave dhe sjellje anti-konkurruese në këto procedura prokurimi. Gjithashtu, fituesit kanë paraqitur ofertat e tyre të cilat janë marrë në konsideratë deri në përfundim të procedurave sipas parashikimeve të ligjit "Për prokurimin publik".
- Nuk është konstatuar ndonjë rotacion, në shpalljen e fituesve të ndërmarrjeve që marrin pjesë në këto procedura. Gjithashtu, rezulton që nuk ka një qëndrueshmëri në pjesët e tregut sipas vlerave të ofertave apo numrit të procedurave të fituara për vitet 2014 dhe 2015, si dhe nuk janë vërejtur shenja të marrëveshjeve të ndaluara, në formën e ofertave në rotacion.

Si përfundim, u konstatua se nuk janë evidentuar shenja të kufizimit të konkurrencës sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003.

*iv. Monitorimi i tregut të karburanteve.*

Tregu i karburanteve ka qenë vazhdimisht në qendër të vëmendjes së AK-së, duke u vlerësuar nëpërmjet procedurave hetimore apo duke u mbajtur nën monitorim.

Monitorimet kanë treguar se tregu i karburanteve paraqitet me struktura të konsoliduara të shtrira në të gjitha nivelet e tregtimit, nga magazina e lirë doganore deri në stacionet e shitjes me pakicë. Investimet në infrastrukturën magazinuese apo në stacionet e shitjes më pakicë, kanë konsoliduar ndërmarrjet të cilat kanë fuqi financiare.

Për pasojë, tregu i importit dhe shitjes me shumicë të karburanteve është i përqendruar, ku ndërmarrjet më të mëdha kanë ruajtur stabilitetin e pjesëve të tregut. Duke qenë një treg që ofron produkte homogjene dhe pa barriera ligjore, vihen re hyrje apo dalje prej tij, por kjo konkurrencë potenciale nuk është e aftë të sjellë ndryshime strukturore.

Problematikat në drejtim të cilësisë së karburanteve apo sigurisë në peshëmatje, kanë bërë që konkurrenca mes firmave të jetë e dobët dhe zgjedhja e konsumatorëve të orientohet jo nga çmimi, por drejt logos së stacionit të pakicës.

Nisur nga këto karakteristika të tregut, monitorimi i realizuar nga Sekretariati pati si qëllim të vlerësojë tre çështje: strukturën e çmimit të importit dhe ngarkesës së barrës fiskale mbi këtë çmim; sjelljen e ndërmarrjeve të pintepruara në lidhje me çmimin e shitjes me pakicë dhe treguesit e tjerë financiarë; vlerësimin e treguesve financiarë të ndërmarrjeve të tregtimit me shumicë dhe pakicë, për të parë për çmime “padrejtësisht të larta” dhe transferim të normave të fitimit nga një nivel tregtimi tek tjetri.

Në përfundim të analizës dhe vlerësimit të treguesve, u konstatua se në nivelin e shitjes me shumicë vihet re fleksibilitet i çmimit të shitjes, i cili ndjek bursën ndërkombëtare dhe çmimin e blerjes, kurse në nivelin e pakicës, çmimi i shitjes është më pak dinamik, duke mos reflektuar çmimin e blerjes.

Integrimi i ndërmarrjeve të karburanteve në të dyja nivelet e tregtimit (shumicë dhe pakicë), ka krijuar politika të çmimit të tilla, ku marzhi më i lartë i fitimit të sigurohet nga ndërmarrjet e shitjes me pakicë të integruara me ato të shitjes me shumicë, marzhi ky i cili është më i lartë se ndërmarrjet e pakicës, që janë të pintepruara. Referuar indeksit ROA u vu re se ndërmarrjet më të mëdha në tregtinë me shumicë dhe pakicë (“Kastrati” SHA dhe “Kastrati” SHPK kanë nivelin më të lartë të kthimit të aktiveve, krahasuar me ndërmarrjet e tjera, indeks ky i përmirësuar në vitin 2015.

Për një ndërmarrje me fuqi të ndjeshme në treg, treguesit e performancës financiare (normë fitimi dhe ROA) ngrenë dyshime për aplikim të çmimeve “padrejtësisht të larta” nga “Kastrati” SHPK. Për të siguruar që sjellja e ndërmarrjeve nuk bie ndesh me ligjin nr.9121/2003; AK do të vazhdojë monitorimin e këtij tregu.

v. *Monitorimi i tregut farmaceutik.*

Tregu farmaceutik është një treg i hapur dhe i liberalizuar, i cili ka qenë shpesh objekt vlerësimi nga AK. Kriteret e përcaktuara në licencimin e ndërmarrjeve të reja në treg, nuk përbëjnë barriera për hyrës të rinj dhe për më tepër, vendosja e tyre është shumë e rëndësishme për sigurimin e një shërbimi cilësor dhe të sigurtë për jetën dhe shëndetin e publikut.

Fakti që në tregun farmaceutik, rreth 45% e barnave janë pjesë e skemës së rimbursimit nga FSDKSH, kushtëzon që një pjesë e tregut të rregullohet në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore të skemës së sigurimit të detyrueshëm shëndetësor.

Urdhri i Farmacistëve, nëpërmjet shkresës nr. 169 Prot., të datës 25.02.2016 drejtuar AK, shpreh pretendimin se vendimi nr. 71, datë 22.12.2015, i Këshillit Administrativ të FSDKSH-së, i cili përcakton kriteret që duhet të plotësojë farmacia për lidhjen e kontratës me Fondin, vendos kritere të cilat mund të krijojnë selektivitet jo të drejtë të subjekteve farmaceutike që do të kontraktojnë Fondin dhe konkurrencë të padrejtë ndërmjet subjekteve farmaceutike; diskriminim të një numri subjektsh farmaceutike, ndonëse ato e zhvillojnë aktivitetin në përputhje me rregullat ligjore në fuqi.

Në zbatim të nenit 69, të ligjit nr. 9121/2003, AK vlerësoi efektet e mundshme të kufizimit të konkurrencës në pjesën e tregut farmaceutik, që i përket rrjetit të hapur të farmacive, nga hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit Administrativ të FSDKSH-së.

Në përfundim të vlerësimit dhe pas seancave dëgjimore me përfaqësues të Këshillit Administrativ të FSDKSH-së, Komisioni i Konkurrencës konstatoi se përdorimi i kritereve të distancave mes farmacive dhe institucioneve shëndetësore si dhe largësisë mes farmacive, për lidhjen e kontratave me FSDKSH, nuk përbëjnë kritere që lidhen me performancën e operatorëve në treg dhe nuk kanë lidhje shkak-pasojë, me sjelljen oportunistike të mjekëve-farmacistëve. Në këto kushte, lind e nevojshme gjetja e instrumenteve alternative nga FSDKSH, për kontrollin e tregut objekt-vlerësimi, nëpërmjet akteve nënligjore, që do të nxjerrë në vijim Këshilli Administrativ i FSDKSH-së.

Gjithashtu, për vlerësimin *ex-post* të aktit administrativ, Komisioni i Konkurrencës, nëpërmjet vendimit nr. 418, datë 30.05.2016 *“Për disa rekomandime mbi vendimin e Këshillit Administrativ të FSDKSH-së, mbi kriteret që duhet të plotësojnë farmacitë dhe agjencitë farmaceutike për lidhjen e kontratave me Fondin”*, vendosi t’i rekomandojë Këshillit Administrativ të FSDKSH, që sipas parashikimeve të nenit 69, të ligjit nr. 9121/2003, të dërgojë paraprakisht pranë AK, projekt aktet që në mënyrë të veçantë, mund të sjellin kufizime sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin.

Projektvendimet dhe aktet e tjera nënligjore, që përcaktojnë kriteret që duhet të plotësojnë farmacitë dhe agjencitë farmaceutike, për lidhjen e kontratave me Fondin dhe procedurat për lidhjen e kontratave standarde për vitin 2017, do të jenë objekt i monitorimit nga ana e AK-së.

Pranë AK-së, ndërmarrja “IMI-FARMA” SHPK (depo farmaceutike), depozitoi Formularin e Ankesës, nëpërmjet së cilit kjo ndërmarrje, ankohet ndaj FSKDSH lidhur me përjashtimin nga

lista e rimbursimit të barnave, të barit me emrin Somatropine 8 mg (24 Nj.N), që importohet nga kjo ndërmarrje.

Nga vlerësimi i aktit, u konstatua se dalja nga tregu i Somatropinës 8 mg dhe 10 mg, sillte rritjen e përqendrimit të tregut për këtë bar, duke kufizuar produktin në treguesin e formdozës dhe të firmës prodhuese farmaceutike.

Kriteri i përdorur nga Komisioni Teknik i Barnave me Rimbursim, në lidhje me çmimin më të ulët, vlerësohet si element i rëndësishëm në rastet e tregjeve monopolistike, ku nuk ka oferta të tjera në treg. Por, në rastin kur tregu ka ofrues të gatshëm, të cilët kanë qenë aktivë në treg, deri në hyrjen në fuqi të listës së rimbursimit për vitin 2016, akti bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003, pasi lista e re e rimbursimit sjell kufizim të ofertës, kufizim të zgjedhjes konsumatore si dhe zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët dhe vendosjen e tyre në gjendje të pafavorshme konkurrence.

Për gjithë sa u vlerësua, Kryetari i AK, nëpërmjet një shkrese zyrtare i kërkon FSDKSH që rritja e konkurrencës në tregun farmaceutik duhet të jetë prioritet i Fondit dhe Ministrisë së Shëndetësisë, ku konsumatori të ketë mundësi zgjedhjeje të cilësisë dhe çmimit në treg; dhe në rast të rishikimit të Listës së Barnave me Rimbursim, të krijojë mundësi për zgjerimin e listës për barin Somatropinë me formdoza dhe prodhues farmaceutik.

Për të dyja çështjet, FSDKSH nuk ka bërë ndryshime në listën e barnave me rimbursim apo në kriteret e lidhjes së kontratave për vitin 2016. Me miratimin e listës së re të barnave të vitit 2017 si dhe kontratën me farmacitë për vitin 2017, do të vlerësojmë impaktin e rekomandimeve të AK-së, mbi dy vendimmarrjet e FSDKSH.

### Monitorime të kryera gjatë vitit 2016 sipas tregjeve përkatëse

TABELA 4

	Nr.
Tregu mediave audiovizive	1
Tregu shërbimit të certifikimit	1
Tregu prokurimit publik në fushën e TIK	1
Tregu karburanteve	1
Tregu farmaceutik	1
<b>Totali</b>	<b>5</b>

### 2.3 Hetimet për marrëveshjet e ndaluara dhe pozitën dominuese.

#### i. Tregu farmaceutik

Nisur nga ankesa e ardhur pranë AK-së, ku pretendohet se ndërmarrja “Fufarma”, kryente shitje të lidhura në tregun e shitjes me shumicë, për produktin farmaceutik “Insulinë Glarkinë

*Lantus*”, me vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 415, datë 04.05.2016 u hap “*procedura e hetimit paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të produktit Insulinë Glarkinë Lantus*”.

Pas kryerjes së procedurave të hetimit paraprak dhe pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurave hetimore në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të produktit mjekësor “Lantus” (Insulinë Glarkinë), rezultoi se:

- Nga analiza e shitjeve sipas datave, nuk arrihet të provohet se ka një lidhje midis shitjes së produktit Lantus Solostar dhe Enterogerminë, që të plotësojë kushtet për një shkelje të mundshme të nenit 9, të ligjit nr. 9121/2003.
- Nga kontrolli i dyfishtë i shitjeve sipas urdhër porosisë, nuk rezultoi (për rastet e shqyrtuara) që klienti, i cili kishte porositur produktin Lantus, të ishte faturuar automatikisht edhe për barin *Enterogerminë*.

Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 440, datë 10.11.2016 vendosi për “*Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të produktit mjekësor “Lantus” (Insulinë)*”, pasi në përfundim të procedurës hetimore, nuk u konstatuan shenja të kufizimit të konkurrencës në këtë treg, për periudhën nën hetim.

*ii. Prodhimi, grumbullimi, përpunimi dhe eksporti i duhanit.*

Nisur nga disa artikuj të publikuar në median e shkruar, në lidhje me monopolin e grumbullimit të duhanit në zonën e Belshit, Elbasan, në zbatim nenit 28, germa “a” të ligjit nr. 9121/2003, inspektorët e AK-së monitoruan situatën në këtë zonë gjeografike, e cila është edhe më e madhja në prodhimin e duhanit në vend.

Nga të dhënat e marra në terren nëpërmjet procesverbaleve të mbajtura me fermerët si edhe pranë ndërmarrjes “MIKA KORÇA”, rezulton se gjatë vitit 2016 kjo ndërmarrje nuk kishte realizuar pagesat kundrejt fermerëve për produktin duhan, të dorëzuar te kjo ndërmarrje.

Pozicioni i monopsonistit (blerësit të vetëm), që zotëron në treg ndërmarrja “MIKA KORÇA” SHA, nuk ka ardhur për shkak të kufizimeve të akteve ligjore apo nënligjore dhe ky pozicion nuk është i ndaluar nga ligji nr. 9121/2003. Por, fuqia që ka kjo ndërmarrje për vendosjen e çmimeve të blerjes dhe mungesa e konkurrencës në blerjen e produktit duhan, përbën indicie se mund të ishim para abuzimit me pozitën dominuese.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendimin nr. 424 , datë 29.06.2016 “*Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit*”, për periudhën kohore 01/06/2015 – 31/05/2016.

Pas vlerësimit të të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurave të inspektimit, të realizuara dhe nga analiza e sjelljes së ndërmarrjes me pozitë dominuese, që ushtron veprimtari në tregun prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit, rezulton se nuk janë gjetur shenja të abuzimit me pozitën dominuese, sipas parashikimeve të nenit 9, të ligjit nr. 9121/2003.

Struktura monopson e tregut të grumbullimit të duhanit në vend dhe shqetësimet e evidentuara gjatë procedurës hetimore, kërkojnë rritjen e konkurrencës në tregun përkatës nëpërmjet hapjes së tregut, si dhe rritjen e fuqisë kundërvepruese të fermerëve, nëpërmjet vetë organizimit.

Gjithashtu, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave siguron se kjo situatë nuk do të ndodhë më në të ardhmen, pasi tashmë janë shtuar operatorët grumbullues, duke zbehur pozicionin dominant të ndërmarrjes “MIKA KORÇA”SHA, dhe në ndryshimet ligjore që pritet të miratohen në Kuvend, janë të sanksionuara mirë, marrëdhëniet e fermerit me grumbullues-përpunuesit.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, me anë të Vendimit nr. 438, datë 05.10.2016, mbylli procedurën e hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit, pasi nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës në bazë të nenit 9, të ligjit nr. 9121/2003.

Gjithashtu, Komisioni vendosi t'i rekomandojë Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave:

- Marrjen e masave për hapjen e tregut të grumbullimit të duhanit, të prodhuar në vend, për të nxitur zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive të tij.
- Asistencën e specialistëve të Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave gjatë procesit të kategorizimit të duhanit sipas cilësisë dhe vendosjes së çmimeve përkatëse, të përcaktuara në kontratat midis palëve, gjatë grumbullimit në stacionet e caktuara nga ndërmarrja.
- Monitorimin e realizimit të pagesave nga ana e ndërmarrjes “MIKA KORÇA” SHA, brenda afateve të parashikuara në kontratën e lidhur nga kjo ndërmarrje me fermerët.

iii. *Furnizimi me karburant i avionëve në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar “Tirana International Airport”.*

Komisioni i Konkurrencës, nëpërmjet vendimit nr. 116, datë 29.05.2009 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes midis “TIA” SHPK dhe “AIR BP Albania”, ka përjashtuar nga ndalimi, marrëveshjen e sipërcituar, pika 3.7 e të cilës i jepte të drejtën ekskluzive “AIR BP”, deri në 31 dhjetor 2014 të tregtimit të karburanteve për avionë.

Pavarësisht se duke filluar nga data 1 janar 2015, ka përfunduar ekskluziviteti i tregtimit të karburanteve për avionë, në zonën gjeografike të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, ky treg mbetet monopol i shoqërisë “Air BP”, si i vetmi operator që ofron këtë shërbim në tregun e transportit ajror të pasagjerëve, bazuar në kontratën “TIA” dhe “ABP”. Kjo e fundit, për shkak të ndërtimit të infrastrukturës përkatëse të furnizimit me karburant, ka ekskluzivitetin e ofrimit të këtij shërbimi, deri më 22 prill 2025.

Shkak për nisjen e procedurave hetimore u bë edhe shkresa e dërguar pranë AK-së, në datën 27.4.2016, nr.157 prot., e Shoqatës së Hidrokarbureve mbi "*Problemet që lidhen me monopolin e furnizimit me kerozinë të avionëve në Tirana International Airport Nënë Tereza,*



në të cilën parashtrohen disa shqetësime mbi pamundësinë e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e importit dhe të shitjes së karburanteve, për të tregtuar karburante për avionë.

Shoqata, kërkoi ndërhyrjen e AK-së në lidhje me (a) mundësinë që duhet t'u jepet edhe kompanive të tjera, të marrin tokë në përdorim për të ofruar infrastrukturën e duhur për furnizimin e avionëve me karburant; (b) kompanitë e tregtimit të hidrokarbureve që mund të bien dakord me kompanitë ajrore, të kenë mundësi të fusin autobotet në territorin e aeroportit, mbështetur në kontrata që mund të lidhin me kompanitë ajrore; si dhe (c) nëse kjo arrihet, kriteret dhe kushtet që do t'u ofrohen kompanive të tjerë, a të mos jenë diskriminuese, si dhe koncesionari të mos ketë të drejtë të kërkojë fitim mbi karburantin, për efekt të monopolit që ka mbi territorin e aeroportit.

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 417, datë 18.05.2016, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e furnizimit të avionëve me karburant, në zonën gjeografike të Tirana International Airport Nënë Tereza mbi ekzistencën ose jo të kufizimeve, shtrembërimeve apo pengimeve të konkurrencës, për periudhën hetimore 1.1.2015 - 18.5.2016.

Nga analiza e tregut të furnizimit me karburant të avionëve JET A -1 karosene në Tirana International Airport Nënë Tereza, u konstatua se vetëm ndërmarrja "AIR BP ALBANIA", është importuese dhe shitëse me shumicë për këtë produkt. Gjithashtu, nga vlerësimi i bilanceve financiare të ndërmarrjes "AIR BP ALBANIA", rezultoi se gjatë vitit 2015, fitimi pas tatimit është i konsiderueshëm, nëse krahasohet me tregun e karburanteve në vend.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 432-432/1, datë 14.9.2016, u shpreh për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të Aeroportit Ndërkombëtar "Tirana International Airport Nënë Tereza", për periudhën janar 2014 – qershor 2016.

Pas përfundimit të raportit nga Sekretariati, rasti i paraqitur është në proces e konsultimit të dosjeve dhe dëgjimit të palëve nën hetim, sipas parashikimeve të nenit 39, të ligjit nr. 9121/2003.

*iv. Prokurimi publik me objekt "Ruajtje objektsh për vitin 2015", ndarë në 13 lote, zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.*

Shkak për nisjen e procedurave, u bë shkresa e dërguar nga DPT, protokolluar pranë AK, nr.417 prot, datë 26.10.2015, ku bëhet më dije se në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga DPT, me objekt "Ruajtje objektsh ku është akomoduar administrata tatimore" e ndarë në 13 lote, është konstatuar se gjatë hapjes së ofertave të operatorëve ekonomikë dhe veçanërisht në lotin e Tiranës, 6 (gjashtë) prej operatorëve ekonomikë ofertues, kanë paraqitur një ofertë ekonomike me vlerë të barabartë. DPT ka vënë në dispozicion të AK, ofertat e ndërmarrjeve që kanë marrë pjesë në procedurën e tenderimit "Ruajtje objektsh ku është akomoduar administrata tatimore".

Nga paraqitja e këtyre ofertave identike, u krijua dyshimi se midis operatorëve mund të ketë marrëveshje të ndaluara, gjë e cila bie ndesh me ligjin nr. 9121/2003.

Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 380, datë 2.11.2015 vendosi për “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ruajtje objektsh për vitin 2015”, ndarë në 13 lote, zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve” për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

Metodologjia e përdorur gjatë hetimit është bazuar në udhëzuesin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike” përshtatur sipas metodologjisë që aplikon OECD, për luftën ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike.

Për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjeve në tregun e prokurimit publik të shërbimit privat të sigurisë fizike, u vlerësuan të dhënat e administruara gjatë fazës së inspektimeve në ndërmarrje si dhe dokumentet e administruara nga Autoriteti Kontraktor, meqënëse gjatë inspektimeve të befasishme, të realizuara në ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi, nuk u gjet asnjë evidencë direkte, që të vërtetonte bashkëpunimin në përgatitjen e ofertave në procedurat e prokurimit publik.

Ofertat identike, në këto kushte, duket se kanë ardhur për shkak të rekomandimit të dhënë nga APP dhe KPP, në datën 1. 4.2015, mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për marrjen e shërbimit privat të ruajtjes fizike, i cili i ka çuar ndërmarrjet drejt çmimit minimal të vlefshëm, që është identik me vlerën e përcaktuar nga APP dhe KPP.

Gjithashtu, për sa më sipër, nuk vërtetohet që ndërmarrjet të kenë aplikuar skemat e marrëveshjeve në oferta të përcaktuara, sipas metodologjisë së përdorur “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, pasi oferta fituese ishte sa 86.91% e fondit limit, duke i dhënë një indicio tjetër analizës, që të çon drejt mungesës së një marrëveshjeje në këtë tender; pasi diferenca e konsiderueshme nga vlera e fondit limit, tregon se nuk jemi para evidencave të një sjelljeje të ndaluar.

Pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurave të inspektimit, të realizuara në ndërmarrjet nën hetim dhe vlerësimit të dokumentacionit të dërguar nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me procedurat e prokurimit me objekt “Ruajtje objektsh për vitin 2015, ndarë në 13 lote, zhvilluar nga DPT”, rezultoi se nuk u konstatuan shenja të bashkëpunimit të ndërmarrjeve në përgatitjen e ofertave në procedurat e prokurimit publik në këtë treg, të parashikuara në nenin 4, të ligjit nr. 9121/2003.

Si përfundim, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 407, datë 08.03.2016 vendosi:

- Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ruajtje objektsh për vitin 2015”, ndarë në 13 lote, zhvilluar nga DPT”, pasi në përfundim të kësaj procedure hetimore nuk u konstatuan shenja të kufizimit të konkurrencës për periudhën nën hetim;
- T’i rekomandojë APP, që në bashkëpunim me Autoritetet Kontraktore, në rastin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike :
  - a. gjatë llogaritjes së fondit limit, të marrin parasysh mbulimin e të gjitha kostove operative dhe një normë fitimi të shoqërive të sigurisë fizike në një normale sipas

llogaritjes së ekspertëve, në mënyrë që të mos caktohet çmimi i ofertuesve nga autoriteti prokurues;

- b. të ndiqet zbatimi i kontratave, pasi vendosja e çmimeve anormalisht të ulta, nënkupton mosmarrjen e shërbimit të prokuruar (numri i posteve të rojeve ose turnet/orët e punës më të ulta se ato të kontraktuara);
- c. përjashtimin nga prokurimi publik, të shoqërive që kanë marrë pjesë në marrëveshje të ndaluara në prokurimet publike sipas vendimmarrjes së AK-së.
- v. *Hetimi i thelluar në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij.*

Pas monitorimit të realizuar në tregun e përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, u krijuan dyshime se mund të kishte një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë treg.

Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 400, datë 10.02.2016 *“Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij”*, nisi hetimin paraprak për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën kohore 1 janar 2014 – 31 janar 2016.

Në përfundim të fazës së hetimit paraprak, u vërejt se nga analizimi i treguesve të përqendrimit, pjesët e tregut të ndërmarrjeve gjatë periudhës nën hetim, si dhe krahasimi i çmimeve të aplikuara nga ndërmarrjet për periudhën hetimore, për produktet në tregun përkatës, ndërmarrjet “Lufra” SHPK dhe “Erzeni” SHPK të cilat zotëronin 75 – 80 % të tregut, paraqisnin dyshime për ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 413, datë 21.04.2016 u shpreh për *“Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij, ndaj shoqërive “Lufra” SHPK dhe “Erzeni” SHPK”*, me objekt ekzistencën ose jo të një marrëveshje të ndaluar ose abuzimit e mundshëm me pozitën e përbashkët dominuese në treg, për periudhën 1 janar 2014 - 31 mars 2016.

Në përfundim të procedurës hetimore u konkludua, se evidencat e grumbulluara gjatë procedurës së hetimit të thelluar në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij, ndaj ndërmarrjeve “Lufra” SHPK dhe “Erzeni” SHPK, nuk vërtetuan shenja të kufizimit të mundshëm të konkurrencës nga një marrëveshje e ndaluar apo abuzim me pozitën dominuese në treg, në kuptim të neneve 4 dhe 9, të ligjit nr. 9121/2003. Sipas raportit hetimor, shqetësimet e identifikuar në tregun objekt hetimi, duhet të adresohen nga institucionet përgjegjëse, me qëllim nxitjen dhe mbrojtjen e konkurrencës.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 444, datë 30.11.2016 vendosi *“Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij ndaj shoqërive “Lufra” SHPK dhe “Erzeni” SHPK”*.

Me anë të këtij vendimi, Komisioni vendosi t’i rekomandojë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministrisë së Financave, AZHBR si dhe DPT:

- Verifikimin e mënyrës së funksionimit të skemës së rimbursimit të TVSH, në tregun përkatës të përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij, sipas udhëzimit nr. 19, datë 03.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë, për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”.
- Analizën e pasqyrave financiare të shoqërive nën hetim “Erzeni” SHPK dhe “Lufra” SHPK, për të parë arsyet e mosreflektimit të shitjeve të rritura nga 2-5 herë, në rezultatin financiar.

*vi. Hetimi paraparak dhe i thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme).*

Nisur nga artikujt në median e shkruar, në lidhje me një rritje të çmimit të sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL), nga të gjitha shoqëritë e sigurimeve me rreth 25 %, në datën 24.8.2016, inspektorët e AK-së realizuan një monitorim në treg.

Nga monitorimi i realizuar pranë agjentëve të shitjes së policave të sigurimit, si dhe nga deklaratimet e këtyre të fundit, konstatohet se në datën 24.8.2016, është realizuar rritja e çmimit të sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL), për të gjitha kategoritë dhe nga të gjitha kompanitë e sigurimit në masën prej 20%.

Kjo rritje, është reflektuar në sistemin online të prerjes së policave të sigurimit (MTPL) nga agjentët të sigurimeve, të të gjitha kompanive të sigurimit, në datën 24.8.2016 gjithashtu vërehej se këto prime shitjeje ndryshonin në mënyrë simetrike nga njëra kompani sigurimi tek tjetra, me të njëjtën masë prej 12 lekësh. Kjo sjellje, mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar, sipas përcaktimeve të nenit 4, të ligjit nr. 9121/2003.

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 430, datë 07.09.2016, vendosi hapjen e hetimit paraparak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme), për periudhën hetimore 1 janar 2016 - 7 shtator 2016.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në inspektim, u vërejt se të gjitha shoqëritë e sigurimit kishin caktuar datën 24 gusht 2016, për aplikimin e çmimeve të ndryshuara për produktin MTPL e brendshme, duke e rritur çmimin për të gjitha kategoritë (16 kategori), në të njëjtën masë me 16.7%, duke e njoftuar shoqërinë “Star Broker” në rrugë shkresore, në datën 23 gusht 2016 (me përjashtim të ndërmarrjes “Ansig”, shkresa e të cilës mban datën 24 Gusht 2016). Në zbatim të kërkesave të mësipërme, shoqëria “Star Broker” SHA ka realizuar ndryshimin e tarifave për kategoritë e MTPL në sistemin e shitjes në të njëjtën kohë, për të gjitha shoqëritë e sigurimit, në datë 24.08.2016, ora 00:00.

Nga krahasimi i primit të shitjes së MTPL, të aplikuar përpara datës 24.08.2016, me primin e shitjes së MTPL, të aplikuar nga data 24.08.2016, u vërejt se masa e rritjes së primit të shitjes është 16.7%, për të gjitha ndërmarrjet dhe për të gjitha kategoritë e produktit.

Si konkluzion, rritja në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën masë e primit të shitjes së produktit MTPL e brendshme, nga të gjitha shoqëritë e sigurimit, që ushtrojnë veprimtari në tregun e

MTPL së brendshme, mund të përbënte një sjellje të bashkërenduar bazuar në nenin 4, pika 1, gërma “a” dhe “c” të ligjit nr. 9121/2003.

Për këtë arsye, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 435, datë 21.09.2016 vendosi *“Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme), ndaj shoqërive të sigurimit të jo jetës”*, për të parë nëse ka ose jo shkelje të nenit 4, të ligjit nr. 9121/2003 dhe vlerësimin e akteve ligjore dhe nënligjore, të cilat mund të sillnin kufizime në tregun përkatës, për periudhën kohore nga 1.1.2016 - 20.9.2016.

Komisioni i Konkurrencës për 2016 vlerësoi se në tregjet e rregulluara, entet rregullatorë dhe në rastin konkret AMF, gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e veprimtarisë ekonomike të subjekteve nën mbikëqyrje, janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e Ligjit nr. 9121/2003 dhe të sigurojnë konkurrencën e lirë dhe efektive në tregjet nën rregullim.

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 443 , datë 30.11.2016 *“Për masat dhe detyrime për ndërmarrjet e sigurimit dhe disa rekomandime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare mbi rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”* vendosi:

- Angazhimet e ndërmarrjeve objekt hetimi, bëhen të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrime, si vijon: a) Lidhjen e më shumë se një kontratave të shërbimit me shoqëritë e brokerimit dhe shoqëritë e agjentëve/agjentë si persona fizikë; b) Rritjen e shërbimit ndaj të siguarave sa i përket dëmeve dhe ofrimit të primeve të ndryshme të shitjes sipas kategorive të klientëve; c) Marrjen e masave, që në sistemet e tyre shoqëritë të mundësojnë sistemin e diferencuar Bonus/Malus;
- T’i rekomandojë Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të detyrojë AMF-në për marrjen e masave për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik, për përgjegjësitë ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme) nëpërmjet nxjerrjeve të akteve nënligjore lidhur me: a) Zbatimin e plotë të sistemit Bonus/Malus për Sigurimin e Detyrueshëm Motorik ndaj Palëve të Treta, duke diferencuar primet e sigurimit të të siguarave sipas historikut të dëmeve; b) Dëmshpërblimin e drejtpërdrejtë për palët e siguruara që do të rriste ndjeshëm konkurrencën mes shoqërive të sigurimeve;

AMF depozitoi ankimimin administrativ për revokim të pjesshëm të vendimit të Komisionit të Konkurrencës, për pjesën e rekomandimeve të dhëna AMF. Komisioni i Konkurrencës pasi e shqyrtoi ankimin u shpreh me vendimin nr. 448, duke rrëzuar ankimimin dhe duke lënë në fuqi vendimin nr. 443, datë 30.11.2016 *“Për masat dhe detyrime për ndërmarrjet e sigurimit dhe disa rekomandime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare mbi rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik, për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”*.

vii. *Hetim i përgjithshëm në sektorin bankar.*

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të monitorimit në tregun bankar, me vendimin nr. 373, datë 16.09.2015, në zbatim të nenit 41, të ligjit nr. 9121/2003 ka hapur

procedurën e “Hetimit të përgjithshëm në sektorin bankar”, për të vlerësuar nëse konkurrenca në këtë sektor është e kufizuar ose e shtrembëruar si pasojë e sjelljes së një ose disa bankave. Ky hetim, ka synuar të vlerësojë konkurrencën në sektorin bankar, identifikimin e problemeve që mund të sjellin kufizim të konkurrencës dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e mjedisit konkurrues në këtë treg jetik, për ekonominë shqiptare.

Në këtë hetim është përdorur modeli Panzar Rosse, i cili ka synuar të ndërtojë statistikën  $H^6$ , për periudhën 2010-2015 në sektorin bankar. Nga përlogaritjet statistika  $H$ , ka rezultuar 0.742, ku konkurrenca në sektorin bankar për periudhën e marrë në analizë është në kushtet e konkurrencës monopolistike.

Produket përkatëse të marra në analizë përfshijnë: llogari rrjedhëse; depozita me/pa afat; kredi konsumatore; kredi kufi (OVD); kredi hipotekore; karta krediti; karta debiti; transfertat bankare; letra me vlerë në tregun primar, të ofruara nga bankat e nivelit të dytë, në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në përfundim të procedurave të hetimit janë propozuar disa rekomandime drejtuar Bankës së Shqipërisë (BSH), me statusin e licencuesit-mbikëqyrësit të sistemit bankar, Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB) dhe bankave të nivelit të dytë.

Autoriteti i Konkurrencës, ka kërkuar komente dhe sugjerime nga BSH dhe AAB mbi raportin e Hetimit Përgjithshëm në Sektorin Bankar dhe rekomandimet e dhëna. Në përgjigje të kërkesës së AK-së, BSH si dhe Shoqata Shqiptare e Bankave kanë paraqitur opinionet dhe komentet e tyre, lidhur me këtë raport dhe rekomandimet e dhëna.

Pas seancës konsultative me BSH dhe AAB, Komisioni i Konkurrencës do të shprehet me vendim sipas parashikimeve të neneve 69 dhe 70, të ligjit nr. 9121/2003.

viii. *Hetim i thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore”*

AK nisur nga një shqetësim në median e shkruar mbi mungesën potenciale të konkurrencës në tregun e shërbimit të sinjalistikës rrugore, kërkoi informacion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, lidhur me procedurat e prokurimit të realizuara me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës loti I dhe loti II.

Ndodhur para një situatë, e cila mund të përmbajë shenja për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregun e prokurimit me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore – vazhdimi” loti I dhe loti II, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, me anë të vendimit nr. 376, datë 15.10.2015, vendosi hapjen e hetimit paraprak në këtë treg, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

Në bazë të raportit të hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës konkludoi se vihen re shenja të kufizimit të konkurrencës, për rrjedhojë u shpreh me vendimin nr. 386, datë 14.12.2015

---

<sup>6</sup> Indeksi i përqëndrimit të tregut, referenca <https://www.justice.gov/atr/herfindahl-hirschman-index>

*“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt: “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore” për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.*

Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e prokurimit publik përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore, janë realizuar bazuar në udhëzuesin *“Mbi Luftimin e Marrëveshjeve të Ndaluar në Oferta në Prokurimet Publike”* përshtatur sipas Metodologjisë që aplikon OECD, për luftën ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike.

Gjatë procedurave të hetimit, KLSH me shkresën nr. 787/18 prot. datë 24.02.2016, i rekomandon AK hetimin për rrezikun e ekzistencës së një marrëveshje të ndaluar në oferta në prokurimet publike, zhvilluar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar për vitet 2014-2015, bazuar në konstatimet nga auditimi i ushtruar në ARRSH për objektet e sinjalistikës rrugore.

AK ka kërkuar nga KLSH, që në vijim të procedurës së hetimit të thelluar të këtij tregu, të vërë në dispozicion faktet dhe provat që disponojn, në lidhje me skemat e rotacionit në të qenit fitues, si dhe elemente të tjera të kontrollit të tregut, ekzistencës së marrëveshjeve të fshehta midis operatorëve dhe monopolizimit të tregut në procedurat e prokurimit, të realizuara nga autoriteti kontraktor *“Autoriteti Rrugor Shqiptar”*.

Në përgjigje të kërkesës së AK, KLSH ka vënë në dispozicion pjesë nga raporti përfundimtar i auditimit të ushtruar në ARRSH. Bazuar në këtë raport, nuk rezultuan prova dhe fakte shtesë lidhur me mundësinë e një marrëveshje të ndaluar, në oferta në prokurimet publike për objektet e sinjalistikës rrugore.

Pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurës hetimore si: dokumentacioni i dorëzuar nga ndërmarrjet ofertuese në procedurën e prokurimit objekt-hetimi dhe dokumentacionit të administruar gjatë inspektiveve të realizuara në selitë e ndërmarrjeve nën hetim, nuk u konstatuan elemente të bashkëpunimit të ndërmarrjeve në përgatitjen e ofertave, në procedurat prokuruese në tregun e prokurimit publik, me objekt *“Përmirësimin, rifreskimin e sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore”*, të parashikuara në nenin 4, të ligjit nr. 9121/2003.

Në përfundim të procedurave hetimore, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendimin nr. 409, datë 21.03.2016, duke i rekomanduar Autoritetit Rrugor Shqiptar hartimin e procesit të prokurimit në mënyrë të tillë, që të nxitet pjesëmarrja e operatorëve të vegjël e të mesëm ekonomike dhe operatorëve të huaj, si: a)zvogëlimin e madhësisë së lotëve, për të rritur mundësinë e pjesëmarrjes të sa më shumë operatorëve në proceset e prokurimeve; b)të shmanget sa më shumë të jetë e mundur, bashkimi i operatoreve si një faktor që rrit mundësinë e bashkëpunimit afatgjatë, në dëm të konkurrencës; c)përcaktimin e afateve kohore të përshtatshme për përgatitjen e ofertave, në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe vlerën e kontratës që do të prokurohet, në veçanti kur në pjesëmarrje mund të përfshihen edhe operatorë të huaj.



**Hetimet për marrëveshjet e ndaluara dhe pozitën dominuese  
gjatë vitit 2016 sipas tregjeve përkatëse.**

**TABELA 5**

	<b>Nr.</b>
Tregu farmaceutik	1
Tregu duhanit	1
Tregu karburanteve & TIA	1
Tregu prokurimit publik	2
Tregu agrobiznesit – qumështi dhe nënproduktet e tij	1
Tregu sigurimeve	1
Tregu bankar	1
<b>Totali</b>	<b>8</b>

**2.4 Përrjashtim nga ndalimi i marrëveshjeve.**


**31**

Sipas nenit 5, të ligjit nr. 9121/2003 mund të përjashtohet nga zbatimi i pikës 1 të nenit 4 çdo marrëveshje, e cila kontribuon në përmirësimin e prodhimit ose të shpërndarjes së produkteve ose në nxitjen e progresit teknologjik apo ekonomik, nëse një pjesë e mjaftueshme e këtyre përfitimeve shkon në favor të klientëve e të konsumatorëve dhe kur: nuk përmban kufizime të veprimtarive të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, që nuk janë të domosdoshme për të arritur objektivat e sipërpërmendur; nuk kufizon, në mënyrë të ndjeshme, konkurrencën në lidhje me produktet apo shërbimet, objekt i këtyre marrëveshjeve.



## 2.4.1 Statistika në lidhje me përjashtimin nga ndalimi i marrëveshjeve.

TABELA 6



## 2.4.2 Përshkrimi i rasteve specifike.

### i. Përjashtim nga ndalimi i marrëveshjes "Digitalb - Operatorë Televizivë".

Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenet 5 dhe 48 e në vijim të ligjit nr. 9121/2003, ka marrë rinjoftimin nga ndërmarrja Digitalb SHA, për përjashtim nga ndalimi të marrëveshjes TIP midis "Digitalb - Operatorë Televizivë" me objekt mbartja e kanaleve TV, në platformën numerike Digitalb.

Qëllimi i marrëveshjes njoftuar, është përfshirja në platformën tokësore dhe satelitore, të kanaleve televizive të 15 operatorëve televizivë, që konsiston në ritransmetimin e sinjalit të kanalit në valë tokësore dhe satelitore në kohë reale (live) dhe pa asnjë ndërhyrje në kanal original. Kanali televiziv, do të ritransmetohet përkatësisht i kriptuar/koduar, sipas parametrave dhe mbulimit territorial të përdorur nga Digitalb.

Me marrjen e informacionit të plotë, në zbatim të nenit 52, të ligjit nr. 9121/2003, është publikuar në faqen e internetit njoftimi lidhur me këtë marrëveshje, për të ftuar palët e treta, për të shprehur opinionet e tyre për marrëveshjen e njoftuar brenda 30 ditëve. Ndërmarrja ABCom, ka shprehur opinionet e veta si palë e tretë, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës për përjashtim nga ndalimi të ndërmarrjes Digitalb ShA. Ndërmarrja TRING TV ShA, ka paraqitur opinionin e saj në lidhje me kërkesën për përjashtim nga ndalimi të Marrëveshjes "Digitalb – Operator Televizivë", duke kërkuar nga AK të vlerësojë marrëveshjen e njoftuar si një marrëveshje të ndaluar, e cila nuk plotëson kushtet për përjashtim. Shoqata e Transmetuesve Televizivë, Kabllorë dhe Valorë Lokalë - RTL, gjykon se marrëveshja e re Tip nuk plotëson kurrësi kushtet për të përfituar nga përjashtimi.

AK i është drejtuar AMA-s, të cilës pasi ju bë e njohur marrëveshja e njoftuar bazuar në nenin 34, të ligjit nr. 9121/2003, ju kërkua të shprehet për qëndrimin e saj lidhur me këtë marrëveshje.

Në zbatim të nenit 39, të ligjit nr. 9121/2003, Komisioni i Konkurrencës organizoi seancën dëgjimore me palët: "ABCOM", TRING dhe Shoqata e Transmetuesve Televizivë Kabllorë e Valorë Lokalë më datë 20.07.2016; Digitalb si dhe rregullatori AMA (Autoriteti i Mediave Audiovizive).

Komisioni i Konkurrencës, u shpreh me vendimin nr. 428, datë 27.07.2016 "Për përjashtimin individual nga ndalimi të Marrëveshjes-Tip "Digitalb - Operatorë Televizivë", pasi bazuar në nenin 5, të ligjit nr. 9121/2003, Komisioni i Konkurrencës çmon se: Marrëveshja tip mes Digitalb dhe operatorëve televizivë, përjashtohet nga ndalimi për të gjithë operatorët që kanë shprehur vullnetin e tyre për të nënshkruar marrëveshjen, në respektim të kushteve dhe detyrimeve: a) Në nenin 5 të hiqet pika 2 "X TV është i detyruar që të mos ofrojë për transmetim kanalën ndaj asnjë platforme/operator tjetër satelitor, tokësor, dixhital, kabllor, apo çdo forme tjetër transmetimi, me apo pa pagesë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë [...]"; Në nenin 5 të hiqet pika 4 : "X TV nuk mund të transmetojë në faqen e tij WEB në kohë reale apo në transmetim direkt" dhe pikat 4.1 dhe 4.2.

Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 429, datë 27.07.2016 "Për disa rekomandime dhe vlerësime ndaj Autoritetit të Mediave Audiovizive" u shpreh se: 1) Në zonat gjeografike (nivel kombëtar, rajonal, lokal), të cilat përfshihen në përcaktimet e nenit 87 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në RSH", detyrimet e mbartjes të përmbushen sipas përcaktimit të këtij neni dhe rregullave të AMA për detyrimin e mbartjes: 2) Palët e interesuara t'i drejtohen organit kompetent AMA, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 97/2013 për çështje që nuk kanë të bëjnë me mbrojtjen e konkurrencës, për sa i takon problematikave që lindin nga zbatimi i atij ligji.

Që të respektohet vendimmarrja e AK nr.428, datë 27.07.2016, pra të hiqet nga përmbajtja e marrëveshjes së përjashtuar nga ndalimi, detyrimi i "X TV" për të mos ofruar për transmetim kanalën, ndaj asnjë platforme/ operatori tjetër satelitor, tokësor, dixhital, kabllor apo çdo forme tjetër transmetimi, me apo pa pagesë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisioni i Konkurrencës, shprehet me vendimin nr. 436, datë 27.09.2016 "Për një ndryshim në vendimin nr. 428, datë 27.07.2016 "Për përjashtimin individual nga ndalimi të Marrëveshjes -Tip "DIGITALB - OPERATOR TELEVIZIV", duke hequr të drejtën ekskluzive të transmetimit dhe shpërndarjes televiziv të kanalit, në të gjitha format e njohura të transmetimit.

*ii. Përjashtimi nga ndalimi i marrëveshjes OSHEE-KESH për tepricat*

ERE dërgoi pranë AK për opinion "Marrëveshjen për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërive KESH SHA dhe OSHEE SHA, për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha me qëllim plotësimin e humbjeve të sistemit të shpërndarjes për vitin 2015".

Pas vlerësimit të marrëveshjes, kushteve të zbatimit të saj dhe përfitimin e interesit publik, me vendimin nr.405, datë 01.03.2016, Komisioni i Konkurrencës miratoi amendimin për "Përjashtimin e marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH dhe OSHEE, për tepricat e energjisë elektrike në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes deri në qershor 2016".

ERE dërgoi përsëri për opinion pranë AK, amendimin e “Marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërive KESH SHA dhe OSHEE SHA për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve të sistemit të shpërndarjes për vitin 2016”. Amendimi përfshinte shtyrjen e afatit kohor të marrëveshjes ekzistuese deri në datën 31 dhjetor 2016.

Gjithashtu, edhe Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) paraqiti për dijeni pranë AK-së kërkesën drejtuar ERE, për respektimin e normave ligjore në lidhje me shqyrtimin e modaliteteve të bashkëpunimit potencial, ndërmjet shoqërive KESH SHA dhe OSHEE SHA në lidhje me furnizimin me energji elektrike, për mbulimin e humbjeve të sistemit të shpërndarjes për vitin 2016, duke pretenduar se marrëveshja dypalëshe e lidhur ndërmjet KESH dhe OSHEE, kufizon konkurrencën duke mos lejuar pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit, për tregtimin e energjisë elektrike të kompanive të licencuara nga ERE.

Për vlerësimin e marrëveshjes, u morën në konsideratë materialet e administruara dhe të vëna në dispozicion nga Shoqata e Furnizuesve të Energjisë Elektrike, informacioni i ardhur nga OSHEE SHA dhe KESH SHA, në lidhje me procedurat e blerjes së energjisë elektrike dhe çmimin e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në janar 2016 nga OSHEE, informacioni ekzistues mbi historikun e çmimeve të shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike në periudhat e mëparshme, dhe përfitimi i interesit publik nga zbatimi i marrëveshjes.

Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 434, datë 21.09.2016, miratoi *“Përjashtimin e marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH dhe OSHEE, për tepricat e energjisë elektrike në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën 1 korrik deri 31 dhjetor 2016”*.

## **2.5 Kontrolli i përqendrimeve.**

Përqendrimet të ndërmarrjeve kemi në rastet kur shkaktohet një ndryshim i qëndrueshëm i kontrollit si rrjedhojë e: a) bashkimit të dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra-tjetra; b) përfitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga një ose më shumë persona fizikë, të cilët njëkohësisht kanë kontrollin e të paktën një ndërmarrje tjetër ose nga një ose më shumë ndërmarrje, mbi një ose më shumë ndërmarrje ose pjesë të këtyre të fundit, përmes blerjes së aksioneve, kuotave ose aseteve, kontratës ose çdo mjeti të ligjshëm; c) kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një ose më shumë ndërmarrje ose të një pjese të këtyre të fundit; dhe d) krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, e cila nuk ka si objekt apo pasojë bashkërendimin e veprimtarive konkurruese ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjesh të pavarura.

Një përqendrim, bëhet objekt shqyrtimi nga ana e AK-së, pra njoftohet në AK për marrje autorizimi, vetëm nëse përmbush kushtin e parashikuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr. 9121/2003: *“Përqendrimet e ndërmarrjeve njoftohen në Autoritet, për të marrë autorizim, nëse në vitin e fundit financiar, para përqendrimit:*


- xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku, në tregun ndërkombëtar, është më shumë se 7 miliardë lekë dhe xhiroja e të paktën një ndërmarrje pjesëmarrëse në tregun e brendshëm, është më shumë se 200 milionë lekë;
- xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku në tregun e brendshëm është më shumë se 400 milionë lekë dhe xhiroja e të paktën një ndërmarrje pjesëmarrëse, në tregun e brendshëm, është më shumë se 200 milionë lekë”.

Përqendrimi që përmbush kushtin e sipërshtuar (neni 12, pika 1 e ligjit nr. 9121/2003), duhet njoftuar brenda 30 ditëve nga lidhja e marrëveshjes për bashkim ose përfitim kontrolli, ose për krijimin e një ndërmarrje të përbashkët.

Gjatë vitit 2016, është vënë re rritja e numrit të njoftimeve të përqendrimeve pranë AK-së. Ky ndryshim, vjen si pasojë e dinamikave në tregun e brendshëm si dhe te transaksioneve mes kompanive të huaja (*foreign to foreign company*), të cilat kanë xhiro në tregun e brendshëm dhe për pasojë, klasifikohen si transaksione të cilat duhet të njoftohen pranë AK-së.

### Përqendrimet e autorizuara për 2016

TABELA 7



#### 2.6 Përqendrimet e autorizuara dhe statistika në lidhje me përqendrimet e autorizuara.

Gjatë vitit 2016, u shqyrtuan në total 21 praktika përqendrimesh, nga të cilat u autorizuan 12 raste lidhur me përfitim të kontrollit, bashkimin e ndërmarrjeve apo krijimin e një ndërmarrje të re, 1 rast i paautorizuar dhe 8 raste vlerësime ligjore.

Përqendrimet e ndodhura u shqyrtuan si për efektet e sjella në treg, parë kjo nga pikëpamja e konsumatorit dhe rritjes së efikasitetit në treg, ashtu edhe nga premiset e mundshme për të krijuar apo forcuar pozitën dominuese të ndërmarrjes së përqendruar në treg, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi si dhe direktivat komunitare.

### **2.6.1 Përfitim kontrolli (i drejtpërdrejtë ose i tërthortë) i një ose më shumë ndërmarrjeve ose i një pjese të kësaj të fundit - Rastet specifike të përfitimit të kontrollit.**

Në zbatim të nenit 10, pika 1) shkronja b) e ligjit nr. 9121/2003, i ndryshuar gjatë vitit 2016, AK mori në shqyrtim këto raste të përfitimit të kontrollit.

Në rastet specifike të përfitimit të kontrollit: Komisioni i Konkurrencës me vendimet e tij konstatoi, se transaksionet nuk shfaqi shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Vendimi nr.398, datë 09.02.2016 autorizoi përqendrimin e realizuar *nëpërmjet përftimit të kontrollit* të shoqërisë SABMiller Plc. nga shoqëria Anheuser Busch InBev. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i prodhimit, shitjes dhe shpërndarjes së birrës.

Vendimin nr.399, datë 9.02.2016 autorizoi përqendrimin e realizuar *nëpërmjet përftimit të kontrollit* të shoqërisë E.H.W. SHPK. nga një ortak i vetëm. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i prodhimit dhe përpunimit të mishit (sallameri dhe proshuta) për konsum për njerëzit, si dhe tregtimi i tyre.

Vendimi nr. 414, datë 04.05.2016, autorizoi përqendrimin e realizuar *nëpërmjet përftimit të kontrollit* të plotë indirekt nga shoqëria Geo-Jade Petroleum Corporation të shoqërisë Bankers Petroleum Ltd., nëpërmjet shoqërisë 1958082 Alberta Ltd. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i kërkimit, zhvillimit, prodhimit, të naftës dhe gazit natyror, tregtimit dhe eksportit të produkteve të naftës dhe gazit.

Vendimi nr. 420, datë 08.06.2016, autorizoi përqendrimin e realizuar *nëpërmjet përftimit të kontrollit* të shoqërisë "Tirana International Airport" SHPK nga shoqëria Keen Dynamics Limited. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shërbimeve të infrastrukturës aeroportuale, që i ofrohen linjave ajrore dhe shërbimet e asistencës në tokë.

Vendimi nr. 421, datë 22.06.2015 autorizoi përqendrimin e realizuar nëpërmjet *përftimit të kontrollit* nga shoqëria Asahi Group Holdings Ltd, të biznesit të birrës të zotëruar nga SABMiller Plc. Treg përkatës në këtë transaksion, u konsiderua tregu i prodhimit, shitjes dhe shpërndarjes së birrës.

Vendimi nr. 422, datë 22.06.2016, autorizoi përqendrimin e realizuar *nëpërmjet përftimit të kontrollit* të shoqërisë Veneto Banca s.p.a. nga shoqëria Quaestio Capital Management SGR s.p.a, nëpërmjet fondit Atlante. Treg përkatës në këtë transaksion, u konsiderua tregu i shërbimeve bankare për individë dhe i shërbimeve bankare për korporata.

Vendimi nr. 425, datë 14.07.2016, autorizoi përqendrimin e realizuar *nëpërmjet përftimit të kontrollit* të tërthortë të shoqërisë A4 Holding s.p.a. nga shoqëria Albertis Infraestructuras s.a. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i ndërtimeve në infrastrukturë.

Vendimi nr. 426, datë 20.07.2016 autorizoi përqendrimin e realizuar *nëpërmjet përftimit të kontrollit* të shoqërisë Insig ShA nga shoqëria Eurosig ShA. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i sigurimit të jetës dhe jo jetës.

Vendimi nr. 427, datë 20.07.2016 autorizoi përqendrimin e realizuar *nëpërmjet përftimit të kontrollit* nga shoqëria Novamatic Gaming Industries GmbH, të 100% të kapitalit të shoqërisë Albanisch Osterreichische Holding Gesellschaft m.b.h. Treg përkatës në këtë transaksionin u konsiderua tregu i lojërave të lotarisë.

Vendimi nr. 431, datë 14.09.2016, autorizoi përqendrimin e realizuar *nëpërmjet përftimit të kontrollit* nga shoqëria Eurokontakt SHPK., të 100% të kapitalit të shoqërisë Lion Real Estate Albania SHPK. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i pasurive të paluajtshme, pra zotërimi, mirëmbajtja dhe qiradhënia e pasurive të paluajtshme.

Vendimi nr. 433, datë 21.09.2016, autorizoi përqendrimin e realizuar *nëpërmjet përftimit të kontrollit* nga shoqëria GMBF Investment S.a.r.l., të shoqërive NV Biscuits Delacre SA dhe United Biscuits Industries SAS, nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave prej çokollate, tregu i prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave në formë kremi, tregu i prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave me përmbajtje qumështi dhe tregu i prodhimit dhe shitjes së biskotave.

Vendimi nr. 445, datë 13.12.2016 autorizoi përqendrimin e realizuar *nëpërmjet përftimit të kontrollit* nga shoqëria Fondi Besa SHA, të shoqërisë VisionFund Albania SHPK. Treg përkatës në këtë transaksion, u konsiderua tregu i kredisë dhe mikrokredisë të ofruar nga SFJB-të.

## **2.7 Mosmiratimi i përqendrimeve – rastet specifike.**

37

*Rasti - Continental Oil & Gas LLC / TransAtlantic Petroleum Ltd / Stream Oil Ltd*

Transaksioni u njoftua me shkresën nr.61 Prot., datë 4 shkurt 2016, nga shoqëria Continental Oil & Gas LLC me objekt: përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë Stream Oil & Gas Ltd (dhe në mënyrë të tërthortë të TransAtlantic Albania Ltd.) nga shoqëria Continental Oil & Gas LLC.

Treg përkatës në këtë transaksionin u konsiderua tregu i kërkimit, zbulimit dhe prodhimit të gazit natyror dhe naftës.

Me shkresën nr. 61/3 Prot., datë 29.03.2016 “Kërkesë për shprehje opiniononi” të AK drejtuar Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, u kërkua opinion në lidhje me përqendrimin në fjalë.

Me shkresën nr. 61/4 Prot., datë 29.03.2016 “Kërkesë” të AK, drejtuar shoqërisë Continental Oil&Gas, kjo e fundit u njoftua se “Procedura e kontrollit të këtij përqendrimi, e parashikuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121/2003, u pezullua dhe do të fillojë menjëherë pas depozitimit të “Marrëveshjes Përfundimtare”, të nënshkruar nga palët Continental Oil & Gas dhe Transatlantic Petroleum Ltd, siç është e parashikuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të datës 14.01.2016.

Me shkresën nr. 61/7 Prot., datë 03.05.2016 “Kërkesë” të AK, drejtuar shoqërisë Continental Oil&Gas, kjo e fundit u njoftua se “Procedura e kontrollit të këtij përqendrimi, e parashikuar në nenin 56, pika 3 të ligjit nr. 9121/2003, do të fillojë menjëherë pas depozitimit të

“Marrëveshjes Përfundimtare” të nënshkruar nga palët Continental Oil & Gas dhe Transatlantic Petroleum Ltd, siç është e parashikuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të datës 14.01.2016.

Transaksioni që realizon përfitim të kontrollit indirekt të vetëm ekskluziv, të shoqërisë Stream Oil & Gas Ltd nga shoqëria Continental Oil & Gas LLC, në kuptim të nenit 10/1/b dhe 12 të ligjit nr. 9121/2003 ishte përqendrim, që duhet të autorizohet nga Komisioni i Konkurrencës por nuk u autorizua për shkak të heqjes së lejeve koncesionare nga ana e shoqërisë Albpetrol.

## **2.8 Raste të shqyrtuara që nuk janë konsideruar objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.**

Në kuadër të nenit 6 të “Rregullores për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, gjatë vitit 2016, pranë AK u paraqitën 8 raste transaksioni, të cilat nuk u konsideruan objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës, si pasojë e mospërbushjes së kriterit të ndryshimit të kontrollit të ndërmarrjeve objekt përqendrimi apo të mospërbushjes së kushtit të xhiros minimale, të parashikuara në ligj.

### *ABCom SHPK – LushiCa TV SHPK*

Transaksioni u njoftua me shkresën nr. 475 Prot., datë 16.12.2015 dhe ka pasur si objekt realizimin e përfitim të kuotave dhe si rrjedhojë, të kontrollit nga shoqëria ABCom Sh.p.k tek shoqëria e re, LushiCa TV SHPK.

Në rastin konkret, Shoqëria LushiCa TV SHPK u krijua në mënyrë të përkohshme për një vit dhe vetëm, me qëllim transferimin e aseteve nga Shitësi tek Shoqëria ABCom SHPK. Për më tepër, të gjitha veprimet e krijimit të LushiCa TV SHPK dhe transferimi i aseteve të saj tek ABCom SHPK, ndodhën pothuajse njëkohësisht dhe për pasojë, nuk rezultuan në ndonjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës.

Transaksioni nuk rezultoi në një ndryshim të kontrollit me baza të qëndrueshme, mbi Shoqërinë e re, dhe për pasojë nuk u klasifikua si përqendrim në bazë të nenit 10), pika 1), shkronja b) e ligjit nr. 9121/2003.

### *Interlogistic sh.p.k. – Z. Edmond Hido*

Transaksioni u njoftua me shkresën nr. 28 Prot., datë 19.01.2016 dhe ka pasur si objekt transferimin e 100% të kuotave të shoqërisë Interlogistic SHPK. nga individ z. Edmond Hido.

Shoqëria Interlogistic Sh.p.k, e cila ishte pjesë e Grupit të Marketing & Distribution, ka qenë objekt i “Kontratës së Shitblerjes, nr. 2925 Rep dhe nr. 217 Kol, më datë 15.12.2015, me objekt transferimin e 100% të kuotave të shoqërisë nga ortaku i vetëm Znj. Majlinda Hido tek individ z. Edmond Hido.



Ky transaksion i ndodhur ndërmjet pjesëtarëve të një familje nuk shkaktoi ndryshim cilësor në kontrollin e shoqërisë Interlogistic Sh.p.k dhe për pasojë, nuk përbënte një përqendrim në kushtin të nenit 10, të ligjit nr. 9121/2003.

Transaksioni i transferimit të 100% të kuotave të shoqërisë Interlogistic SHPK nga ortaku i vetëm Znj. Majlinda Hido tek z. Edmond Hido, nuk krijoi kushtet për një ndryshim të qëndrueshëm të kontrollit në ndërmarrjen në fjalë, nuk përbëri një përqendrim dhe për pasojë, në bazë të nenit 56 të ligjit nr. 9121/2003, nuk ishte objekt për dhënien e autorizimit nga Komisioni i Konkurrencës.

#### *Amadeus Group It s.a. – Adria Airways Slovenski Letalski Prezovnik*

Transaksioni u njoftua pranë AK-së me anë të shkresës nr. 94 Prot., datë 25.02.2016. Transaksioni u realizua në bazë të "Marrëveshje për shitblerjen e kuotave" e nënshkruar midis Amadeus Group It S.A (blerësi) dhe Adria Airways Slovenski Letalski Prezovnik (shitësi), më datë 1 shkurt 2016, me objekt përfitim të kontrollit të plotë dhe të vetëm nga blerësi të shoqërive (i) Amadeus Slovenia Podjeje d.o.o,(ii) NMC Shkup d.o.o.e.l dhe (iii) NMC Tirana Sh.p.k (targeti), me anë të përfitimit të të gjithë kapitalit aksionar në këto të fundit.

Nga vlerësimi paraprak i dosjes, rezultoi se transaksioni i përfitimit të kontrollit të plotë dhe të vetëm, nga shoqëria Amadeus Group IT të shoqërive (i) Amadeus Slovenia Podjeje d.o.o,(ii) NMC Shkup d.o.o.e.l dhe (iii) NMC Tirana Sh.p.k, me anë të përfitimit të të gjithë kapitalit aksionar të shoqërisë Adria Airways Slovenia përbënte një përqendrim, i cili plotëson kushtin e nenit 10, pika 1, shkronja b) të ligjit nr. 9121/2003. Por, në këtë rast nuk u plotësua kushti i xhiros në tregun e brendshëm sipas nenit 12 të ligjit nr. 9121/2003 dhe për pasojë, nuk ishte objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

#### *Banka Credins Sh.a - Rregjistri Shqiptar i Titujve Alreg SHA*

Me shkresën nr. 141 Prot., datë 8 prill 2016, AK u njoftua për transaksionin e krijimit të shoqërisë së re Regjistri Shqiptar i Titujve Alreg SHA, ku Banka Credins SHA është aksionere me 95% të aksioneve. Bazuar në vendimin e Asamblesë së Aksionerëve, me nr. 6, datë 29.06.2015 në lidhje me projektin "Tregu i Titujve OTEAmf", si dhe në vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm me nr. 13584, datë 16.03.2016, "Banka Credins" SHA do të krijojë për herë të parë një shoqëri aksionere, e cila do të ofrojë shërbimet e kleringut dhe shlyerjes së transaksioneve në tituj. Ndërmarrja e krijuar rishtazi, ku Banka Credins do të zotërojë 95% të aksioneve, ka marrë edhe miratimin paraprak nga AMF me vendimin nr. 133, datë 26.11.2015, quhet Regjistri Shqiptar i Titujve, ALREG SHA.

Nga vlerësimi paraprak i dosjes, rezultoi se transaksioni i krijimit të një shoqërie të re Alreg SHA nga Banka Credins SHA dhe një personi fizik, nuk përmbushte kushtin për të qenë një Joint Venture, pasi nuk plotësoi kushtin sipas së cilit një ndërmarrje e re, duhet të krijohet nga disa ndërmarrje-mëma me të drejta dhe kontroll të përbashkët dhe të barabartë mbi të, nuk përbën një përqendrim pasi nuk plotëson kushtin e nenit 10 pika 3) të Ligjit nr. 9121/2003 dhe për pasojë, nuk është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.



*Ndryshimi i strukturës së zotërimit të kapitalit të Keen Dynamics Limited, blerësi i Tirana International Airport .*

Me shkresën nr. 274 Prot., datë 21 korrik 2016, AK u njoftua në lidhje me ndryshimin e strukturës së zotërimit të kapitalit të Keen Dynamics Limited, blerësi i Tirana International Airport.

Shoqëria FAL dhe nëpërmjet saj edhe shoqëria CEL, kanë aktualisht kontrollin maxhoritar dhe vendimtar në shoqërinë shqiptare Tirana International Airport Sh.p.k. Pas realizimit të transaksionit të pritur ndërmjet ortakëve fundorë të shoqërisë Keen Dynamics Ltd, CEL dhe FPAM, në lidhje me 25% të kuotave të zotëruara nga CASIL tek Keen Dynamics Ltd, shoqëria CEL (nëpërmjet FAL) do të bëhet pronare e ligjshme e 100% të kapitalit të shoqërisë Keen Dynamics Ltd, duke marrë kështu kontrollin e vetëm ekskluziv në këtë të fundit.

Operacioni i përfundimit të kontrollit të plotë dhe të vetëm indirekt, nga shoqëria CEL i shoqërisë Keen Dynamics Ltd, me anë të përfundimit 25% të kapitalit në këtë të fundit, nuk shkakton një ndryshim cilësor të kontrollit në shoqërinë Keen Dynamics Ltd dhe për pasojë, nuk përbën një përqëndrim në kuptim të nenit 10 pika 1, shkronja b) të ligjit nr. 9121/2003.

Transaksioni i njoftuar nuk përbente një përqëndrim, pasi nuk plotësonte kushtin e nenit 10, të ligjit nr. 9121/2003 dhe për pasojë, nuk është objekt për dhënien e autorizimit nga Komisioni Konkurrencës, në bazë të nenit 56, të ligjit nr. 9121/2003.

*Mbi ndryshimin e emrit të rrjetit të supermarketeve “Carrefour” në “InterSpar”.*

40

Nga vëzhgimet e fundit në terren si dhe nga konsultimet me shtypin e shkruar, rezultoi se rrjeti i supermarketeve nën emrin tregtar “Carrefour”, ka ndryshuar emërtim në “Interspar”.

Nga ekstrakti historik i shoqërisë Spar Albania SHPK rezultoi se: rrjeti i supermarketeve “Interspar” administrohej nga shoqëria Spar Albania SHPK, e cila kishte ndryshuar emërtim nga Almark SHPK, në Spar Albania SHPK, në 11 gusht 2016. Aksioner i vetëm, 100% i shoqërisë Spar Albania SHPK, ishte Grupi Balfin. Shoqëria shfrytëzonte të gjithë rrjetin e supermarketeve që i përkisnin shoqërisë CM Balkans SHPK, nën markën Carrefour. CM Balkans, e cila tashmë ka ndryshuar emrin në “Qendra e Shpërndarjes së Ushqimit” është tërhequr nga shitja e produkteve në supermarketet Carrefour që në prill 2015, për shkak të borxheve të mëdha të akumuluar. Që prej prillit 2015, rrjeti i supermarketeve ishte administruar nga shoqëria Almark SHPK, sot Spar Albania SHPK.

Nga ekstraktet e dy shoqërive nuk rezultoi asnjë tjetërsim kuotash ndërmjet dy shoqërive të sipërpërmendura, në lidhje me aktivitetin e tregtimit të produkteve ushqimore me pakicë.

Për sa më sipër, nuk rezultoi asnjë ndryshim kontrolli në shoqërinë Qendra e Shpërndarjes së Ushqimit.

Rrjeti i supermarketeve Carrefour tashmë administrohet nga shoqëria Spar Albania SHPK nën markën “Interspar”.

*Ilbak Madencilik Ve San. Tic. A.S - Tete Albania Tunnel & Mining SHPK.*

Shoqëria Tete Albania Tunnel & Mining Sh.p.k depozitoi një kërkesë për vlerësim paraprak të transaksionit, të realizuar ndërmjet Tete Madencilik Sanayi Ve Muhendislik Ticaret A.S (“Shitësi”) dhe Ilbak Madencilik Ve San. Tic. A.S (“Blerësi”), me objekt shitjen e 51% të kuotave të shoqërisë Tete Albania Tunnel & Mining SHPK. Ky paranjoftim u bë me anë të shkresës nr. 317 Prot., datë 26.09.2016, në bazë të nenit 6, të rregullores “Për procedurat e kontrollit të njoftimit të përqendrimeve”.

Shoqëria Tete Albania Tunnel & Mining SHPK (“Tete”) ishte një shoqëri e themeluar nga shoqëria turke Tete Madencilik Sanayi Ve Muhendislik Ticaret A.

Ortaku i vetëm i shoqërisë Tete Madencilik Sanayi Ve Muhendislik Ticaret A.S kishte nënshkruar “Kontratën e Shitjes” së transaksionit të transferimit të 51% të kuotave të shoqërisë shqiptare Tete, me shoqërinë turke Ilbak Madencilik Ve San. Tic. A.S, në datën 02.09.2016.

Transaksioni i transferimit të 51% të kuotave të shoqërisë Tete nga Shitësi, tek Blerësi, shkaktoi ndryshim në cilësinë e kontrollit të shoqërisë Tete, në formën e ndryshimit nga kontroll i vetëm në kontroll të përbashkët, duke krijuar një përqendrim në bazë të nenit 10, pika 1) shkronja b) të ligjit nr. 9121/2003.

Palët në transaksion nuk plotësonin kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, germa a) të ligjit nr. 9121/2003.

41

Për sa më sipër ky transaksion, i cili edhe pse përbënte një përqendrim në kuptim të Ligjit nr. 9121/2003 nuk plotësonte kriterin e xhiros dhe për pasojë, nuk ishte objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

*Petroleum Consulting Partners A.G. - GFI Albania SHPK.*

Autoriteti i Konkurrencës në bazë të njoftimeve nga media dhe pas verifikimit të informacionit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (Biznesit) mbi transaksionin e përfundimit të 99.9%, të kapitalit të regjistruar të shoqërisë GFI Albania SHPK nga Global Fluids International S.A, tek Petroleum Consulting Partners A.G., i realizuar më datë 01.09.2015, filloi procedurën e kontrollit të përqendrimit. Sipas neneve 10 dhe 12, të Ligjit nr. 9121/2003, çdo përqendrim i realizuar duhet të marrë autorizimin e Komisionit të Konkurrencës, në rastet e plotësimit të kriterëve lidhur me ndryshimin e qëndrueshëm të kontrollit dhe kufirit të xhirove të realizuara në tregun e brendshëm dhe tregun ndërkombëtar.

Me shkresën nr. 467 Prot., datë 14.12.2015 u njoftua shoqëria GFI Albania SHPK, në lidhje me detyrimin për njoftim të përqendrimit, si pasojë e transaksionit të ndodhur me anë të përfundimit të 99.9% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë GFI Albania Sh.p.k nga Global Fluids International S.A tek Petroleum Consulting Partners A.G., i realizuar më datë 01.09.2015.

Me shkresën nr. 467/5 Prot., datë 22.01.2016, Sekretariati i kërkoi sërish GFI Albania pasqyrat financiare të Global Fluids International S.a, Eurocontrol Technics Group Inc. dhe Petroleum Consulting Partners A.G. Megjithëse kishte kaluar afati i parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe kërkesa ishte bërë sipas nenit 33, të ligjit nr. 9121/2003, nga ana e ndërmarrjes GFI Albania nuk u kthye përgjigje, duke penguar vlerësimin e kriterit të xhiros sipas nenit 12, të ligjit nr. 9121/2003, për autorizimin e këtij përqendrimi.

Komisioni i Konkurrencës me vendimin e tij nr. 403, datë 23.02.2016 kërkoi nga shoqëria GFI Albania sh.p.k. depozitimin e pasqyrave financiare për vitin financiar 2014, për shoqërinë Petroleum Consulting Partners A.G.

Komisioni i Konkurrencës më datë 20 tetor 2016 zhvilloi seancën dëgjimore me përfaqësuesit e shoqërisë GFI Albania SHPK, gjatë të cilës u diskutua mbi pasqyrat financiare për vitin 2014 të shoqërisë Petroleum Consulting Partners A.G. Komisioni i Konkurrencës kërkoi edhe një herë depozitimin e pasqyrave financiare 2013 dhe 2014 për shoqërinë Petroleum Consulting Partners A.G, të cilat duhet të ishin sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit si dhe të përafruara me legjislacionin shqiptar.

Me shkresën nr. 359/1 Prot., datë 15.11.2016 shoqëria GFI Albania SHPK dërgoi pranë AK-së dokumentacionin e kërkuar.

Si përfundim, nga vlerësimi i të dhënave financiare të raportuara, rezultoi se nuk plotësohej kushti i nenit 12, të ligjit nr. 9121/2003 në lidhje me xhiron në tregun ndërkombëtar, dhe për pasojë përqendrimi nuk ishte objekt për dhënien e autorizimit nga Komisioni i Konkurrencës.

## **2.9 Rishikimi i të drejtave ekskluzive.**

Edhe gjatë vitit 2016, AK ka vijuar kryerjen e vlerësimeve të të drejtave të veçanta dhe ekskluzive të dhëna, duke pasur parasysh mbrojtjen dhe ruajtjen e parimeve të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi, ka rezultuar se përgjithësisht gjatë procedurës për dhënien e koncesioneve vazhdon të mos respektohet gjithmonë detyrimi i nenit 69, i ligjit 9121/2013, i cili përcakton se: *“Organet e administratës qendrore dhe vendore kërkojnë vlerësimin e Autoritetit për çdo projekt akt normativ: që, në mënyrë të veçantë, ka të bëjë me: a) kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin; b) vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara; c) imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes”*, për të marrë vlerësimin e AK-së gjatë procedurës së dhënies së të drejtave ekskluzive.

Gjatë vitit 2016, Komisioni i Konkurrencës është shprehur me vendime vetëm për 2 (dy) raste të të drejtave ekskluzive; në një rast kur është kërkuar vlerësimi paraprak nga ana e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe në një rast tjetër, vlerësimi është bërë me nismën e vetë AK-së.

## 2.9.1 Statistika në vite në lidhje me rishikimin e të drejtave ekskluzive.

TABELA 8

Të drejtat ekskluzive (koncesionet) sipas viteve	2014	2015	2016
Kontrata e koncensionit për projektimin, financimin dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave.			
Tregu i të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në RSH.			
Kontrata e koncensionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të konte nierëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit.			
Kontrata koncensionare për administrimin, operimin dhe mirëmbajtjen e terminalit lindor të Portit të Durrësit.			
Marrëveshja e Licencës për Lotarinë Kombëtare.			
Kontrata e koncensionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës.			
Kontrata e koncensionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve.			
Draft-amendamenti i Marrëveshjes Koncensionare mes Qeverisë së RSH dhe Tirana International Aeroport.			
Draft-kontrata koncensionare partneriteti publik privat i formës ROT “Për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e infrastrukturës hekurudhore Fier-Ballsh, Fier-Vlorë.			

## 2.9.2 Përshkrimi i rasteve për dhënien e të drejtës ekskluzive.

### i. E drejta ekskluzive për infrastrukturën hekurudhore Fier-Ballsh, Fier-Vlorë.

Koncensionimi partneriteti publik-privat i formës ROT, për infrastrukturën hekurudhore Fier-Ballsh, Fier-Vlorë.

Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 396, datë 26.01.2016 ka dhënë disa rekomandime mbi draft-kontratën koncensionare partneriteti publik-privat i formës ROT “Për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e infrastrukturës hekurudhore Fier-Ballsh, Fier-Vlorë”. Kjo projekt-kontratë koncensionare, parashikonte vendosjen e një të drejte ekskluzive duke e përcaktuar, ndërmarrjen koncensionare si operatorin e vetëm në zonën gjeografike të përcaktuar për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e infrastrukturës hekurudhore. Kjo draft-kontratë, bazohet në partneritetin publik – privat dhe u konsiderua si një formë e liberalizimit të sektorit të shërbimit hekurudhor, i cili ka qenë pothuajse jashtë funksionimit. Komisioni i Konkurrencës vendosi se kjo draft-kontratë, nuk bie në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.

9121/2003, por në zbatim të dispozitave të këtij ligji, AK ka kompetencën për të monitoruar sjelljen e kësaj ndërmarrjeje në treg, për të parandaluar dhe identifikuar rastet e abuzimit potencial me pozitën dominuese në këtë treg monopol.

Komisioni i Konkurrencës me këtë vendim i rekomandoi Autoritetit Kontraktor, Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, që në zbatim të Kontratës të Konkensionit/Partneriteti Publik-Privat të formës ROT për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e infrastrukturës hekurudhore Fier-Ballsh dhe Fier-Vlorë”, tarifat e miratuara nga Autoriteti Kontraktor të jenë të orientuara drejt kostos. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës duhet t’i drejtohet AK-së, në rastet kur gjykon se vërehen shkelje të mundshme të ligjit nr. 9121/2003, gjatë periudhës konkensionare.

*ii. Vlerësimi i tregut të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në RSH.*

Tregu i kontrollit teknik të automjeteve, siguron një shërbim publik të detyrueshëm për përdoruesit e mjeteve motorike dhe ofrohet në treg vetëm nga një ndërmarrje, e cila gëzon të drejta të përcaktuar nga marrëveshja e Konkensionit “Për dhënien me Konkension të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre, në Republikën e Shqipërisë”, e nënshkruar në datë 03.09.2009, sipas ligjit nr. 9663, dt. 18.12.2006 “Për Konkensionet”- i ndryshuar dhe kuadrit nënligjor të tij, mes Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit (tani Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI)) dhe Konkensionari: SOCIETE GENERALE DE SURVEILLANCE S.A, kompani e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjenezës. Në përputhje me marrëveshjen konkensionare, tregu i shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve është treg i modelit të centralizuar (i ndarë nga shërbimi i servisit), me një ndërmarrje të vetme të ofrimit të shërbimit.

Pas vlerësimit *ex-post* të marrëveshjes konkensionare, AK nëpërmjet vendimit nr. 312, datë 18.04.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me funksionimin e tregut të shërbimit teknik të automjeteve”, vendosi t’i rekomandojë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, që në periudhë afatshkurtër, të kërkojë nga konkensionari SOCIETE GENERALE DE SURVEILLANCE S.A(SGS), të krijojë më shumë se një mundësi, për zgjedhjen e konsumatorit për kryerjen e kontrollit të detyrueshëm teknik vjetor të automjeteve në qytetin e Tiranës dhe; në periudhë afatgjatë, të shikohet mundësia e ofrimit të kontrollit teknik të automjeteve nga disa operatorë.

Mbështetur në metodologjitë më të mira të së drejtës së konkurrencës si dhe fazën në të cilën ndodhet kontrata konkensionare, vlerësimi i rastit u fokusua në dy drejtime: a) vlerësimi i performancës së ndërmarrjes Konkensionare si dhe e cilësisë së shërbimit; dhe b) dinamikat e ndryshimit të çmimit si dhe krahasimi me rajonin.

Nga analiza e treguesve të performancës u konstatua se konkensionari ka realizuar investime në krijimin e mjediseve të përshtatshme për punë, investime në pajisje dhe software, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës si dhe direktivat e BE, ka sjellë eksperiencën më të mirë të ndërmarrjes “mëmë” me specialistë dhe pajisje, ka

realizuar aplikimin “on-line” të rezervimit të datës së kontrollit teknik, në website zyrtar ka informacion të plotë mbi procedurat, dokumentacionin, adresat, kontaktet për një shërbim të shpejtë si dhe ka vënë në dispozicion të klientëve, një numër kontakti ( i afishuar edhe në ambientet ku kryhet kontrolli teknik) për çdo sjellje abuzive nga ana e punonjësve të ndërmarrjes koncensionare.

Pavarësisht performancës ekonomike-financiare, vlerësimi i shërbimit nga këndvështrimi i klientëve, i evidentuar nëpërmjet pyetësorëve tregoi se: a) automjetet më problematike për përmbushjen e kriterëve të kolaudimit teknik janë automjetet me lëndë djegëse me benzinë, por pa gjetur elemente detyruese nga koncensionari, për të vendosur pajisje shtesë në automjet për zvogëlimin e emetimit të gazrave; b) mungon ndërgjegjësimi i klientëve për aplikimin e rezervimit paraprak të orës së marrjes së shërbimit, duke sjellë vonesa dhe rradhë në realizimin e procedurës së kontrollit; c) plotësimi i një deklaratë-tip, të hartuar nga koncensionari, e vendos përfituesin e shërbimit në kushte të pafavorshme, në rastin e shkakimit të dëmit gjatë procedurës së kontrollit teknik; d) ekziston ende edhe dukuria e pagesave shtesë, informale, për të kaluar provën e kontrollit teknik.

Në lidhje me vlerësimin e tarifave të shërbimit sipas përcaktimit në kontratën koncensionare, AK, nëpërmjet vendimit nr. 416, datë 18.05.2016 “Për disa rekomandime për rishikimin e tarifave dhe mbi hapjen e tregut të shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve”, u rekomandoi palëve kontraktore që para ndryshimit të tarifave të shërbimit, palët duhet të paraqesin pranë AK, informacionet përkatëse mbi analizën ekonomike për vendosjen e këtyre tarifave të reja. Për vitin 2016 e në vazhdim, koncensionari nuk ka ndryshuar tarifat e shërbimit për kontrollin teknik të automjeteve.

Në lidhje me përmirësimin e shërbimit, Komisioni i rekomandoi Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, të marrë masa për hapjen e këtij tregu për konkurrencë, sipas praktikave dhe standardeve më të mira ndërkombëtare pas përfundimit të periudhës koncensionare.

## **PJESA E TRETË**

### **AUTORITETI I KONKURENCËS PËRBALLË PROCESIVE GJYQËSORE**

Autoriteti i Konkurrencës i kushton gjithmonë kujdes dhe vëmendje të veçantë ndjekjes dhe ecurisë së proceseve gjyqësore. Vendimmarrja e Komisionit të Konkurrencës, është një tregues domethënës në funksion të sigurimit të një konkurrence të lirë dhe efektive në treg.

Gjatë vitit 2016 janë dhënë 52 vendime nga Komisioni i Konkurrencës, kundrejt të cilave është ushtruar e drejta ankimit për vetëm 1 (një) vendim.

Nga ana tjetër, krahas vendimit të ankimuar për herë të parë gjatë vitit 2016, veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës në raport me procesin gjyqësor, ka vazhduar edhe kundrejt atyre çështjeve, të cilat janë duke u gjykuar në Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Vendimet e dhëna nga Komisioni Konkurrencës në vite, që kanë konkluduar në shkelje të ligjit dhe që përmbajnë ndëshkime për ndërmarrjet, i janë nënshtruar ankimit në gjykatë, për arsyen themelore të prekjes së interesave ekonomikë-financiarë të kundërvajtësve ndaj ligjit nr.9121/2003.

Duke i referuar ankimeve të subjekteve ankimues, rezulton se vendimet e Komisionit të Konkurrencës, në vite janë ankimuar vetëm për themelin e çështjes dhe jo për anën procedurale, çka evidenton faktin se Autoriteti i Konkurrencës, respekton me rigozitet procedurat hetimore-administrative, rast pas rasti.

### 3.1 Statistika në lidhje me çështjet gjyqësore në 3 shkallët e gjyqësorit.

TABELA 9

	Gjykata Adm. Shk. I (Padi)	Gjykata Adm. Apel (Ankim)	Gjykata e Lartë (Rekurs)
<b>Çështje në shqyrtim</b>	<b>1</b> <i>Landeslease</i>	<b>9</b> <i>Plu Tirana Lines TUT AMC Eurogjici Hyundai Geci Landeslease TUT</i>	<b>11</b> <i>Romano Port Alba Trans Nazeri AMC ARMO Classic Atlas Intersig Ferlut Eurogjici TUT</i>
<b>Çështje të shqyrtuara</b>	<b>1</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
<b>Fituar</b>	<b>1</b> <i>Landeslease</i>	<b>2</b> <i>TUT Geci</i>	<b>2</b> <i>Intersig Romano Port</i>
<b>Humbur</b>	-	<b>1</b> <i>Eurogjici</i>	<b>2</b> <i>Classic Atlas</i>

### 3.2 Çështje në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë gjatë vitit 2016 ka qenë për shqyrtim vetëm 1 (një) çështje, për të cilën ajo është shprehur me vendim.

1. Çështja administrative me Paditës: Shoqëria "Landeslease" SHPK; I Paditur: AK; Person i Tretë: Shoqëria "MUKA" SHPK; me Objekt: "Shfuqizimi i Vendimit nr. 412, datë 21.04.2016 "Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e qirasë financiare dhe në sektorin financiar"" i Komisionit të Konkurrencës. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pas shqyrtimit të kësaj çështjeje, me vendimin nr. 3898, datë 21.07.2016 ka vendosur: Rrëzimin e kërkesë-padisë; duke lënë në fuqi vendimin e AK-së. Kundër këtij Vendimi nga ana e ndërmarrjes është kryer ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.

### 3.3 Çështje në Gjykatën Administrative të Apelit.

Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë ( e vetme) gjatë vitit 2016 kanë qenë për shqyrtim 9 çështje, nga të cilat: 3 janë shqyrtuar dhe mbeten 6, për t'u shqyrtuar në 2017.

1. Çështja administrative me Paditës: Shoqëria "PLUS COMMUNICATION" SHA, i Paditur: AK; Person i Tretë: Shoqëria "VODAFONE ALBANIA" SHA dhe AKEP, me Objekt: Ndryshim i pjesshëm i aktit administrativ, vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr.



303, datë 16.01.2014. "Për mbylljen e hetimit të thelluar ndaj "Vodafone Albania" SHA dhe rekomandime për AKEP". Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë vendosi rrëzimin e padisë së ndërmarrjes, duke lënë në fuqi vendimin e AK-së. Kundër këtij vendimi, nga ana e ndërmarrjes "PLUS" është kryer ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.

2. Çështja administrative me Paditës: Shoqëria "Tirana Lines"; i Paditur: AK; me Objekt: Kundërshtim i vendimit nr. 290, dt. 23.07.2013 të Komisionit të Konkurrencës, për pjesën që i takon Paditësit. Kjo çështje ishte duke u gjykuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe nga ana e gjyqësorit i kaloi për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë vendosi rrëzimin e padisë, duke lënë në fuqi vendimin e AK-së. Kundër këtij vendimi nga ana e ndërmarrjes është kryer ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.
3. Çështja administrative me Paditës: Shoqëria "Tirana Urban Trans"(TUT); I Paditur: AK; me Objekt: Kundërshtim i vendimit nr. 290, datë 23.07.2013 të Komisionit të Konkurrencës, për pjesën që i takon paditësit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë vendosi rrëzimin e padisë së ndërmarrjes, duke lënë në fuqi vendimin e AK-së. Kundër këtij vendimi nga ana e ndërmarrjes është kryer ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, e cila me vendimin nr. 554, datë 17.03.2016 vendosi: Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë. Kundër këtij vendimi. ka paraqitur Rekurs në Gjykatën e Lartë Paditësja, shoqëria "Tirana Urban Trans" SHA; dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.
4. Çështja administrative me Paditës: "AMC" SHA; I Paditur: AK; me Objekt: Pavlefshmëria e vendimit nr. 59, datë 09.11.2007 të Komisionit të Konkurrencës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë në lidhje me këtë çështje ka vendosur rrëzimin e Padisë, duke konfirmuar ligjshmërinë e vendimit nr. 59, datë 09.11.2007 të Komisionit të Konkurrencës. Kundër këtij vendimi pala paditëse "AMC" SHA, paraqiti ankimi pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila pas shqyrtimit vendosi lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Kundër këtij vendimi "AMC" paraqiti Rekurs pranë Gjykatës së Lartë, e cila pasi e shqyrtoi vendosi kthimin për rigjykim të kësaj çështjeje pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.
5. Çështja administrative me Paditës: "Eurogjici Security" SHPK, "Eurogjici, Security 1" SHPK, "Toni Security" SHPK; I Paditur: AK; me Objekt: Kundërshtim i vendimit nr. 240, datë 26.07.2012 të Komisionit të Konkurrencës "Për Vendosje Gjore". Secila nga palët paditëse, ka ngritur padi më vete kundër AK. Në lidhje me këto çështje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi pranimin e padisë. Kundër këtij vendimi nga ana e AK-

së është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata e Apelit Tiranë, në lidhje me këtë çështje shpalli moskompetencën lëndore, në zbatim të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 dhe i kaloi për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, e cila me vendimin nr. 1400, datë 30.05.2016 vendosi: Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur Rekurs në Gjykatën e Lartë, i Padituri, AK; dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.

6. Çështja administrative me Paditës: “Hyundai” SHPK; i Paditur AK, me Objekt: “Shfuqizimi i aktit administrativ, vendimi nr. 154, datë 01.10.2010 të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës, lidhur me gjobën për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pas shqyrtimit të kësaj çështjeje me vendimin nr. 4543, datë 21.09.2015 ka vendosur: Rrëzimin e Kërkesë-Padisë; duke lënë në fuqi vendimin e AK-së. Kundër këtij vendimi, nga ana e ndërmarrjes është kryer ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.
7. Çështja administrative me Paditës: Shoqëria “Tirana Urban Trans” (TUT) SHPK; të Paditur: Zyra Përmbartimore Tiranë dhe AK, me Objekt: Shfuqizimin e aktit administrativ, vendimi nr. 290, datë 23.07.2013 i Komisionit të Konkurrencës, për arsye se ai është shuar për shkak të parashkrimit nga ligji. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vendosi: Pranimin e Kërkesë-Padisë. Kundër këtij vendimi nga ana e AK-së është kryer ankim në Gjykatën e Administrative të Apelit, Tiranë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.
8. Çështja administrative me Paditës: Shoqëria “GECI” SHPK; i paditur: Zyra Përmbartimore Tiranë dhe AK, me Objekt: Pavlefshmëri e titullit ekzekutiv, vendim nr. 229, datë 07.07.2012 të Autoritetit të Konkurrencës. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 229, datë 07.07.2012 të AK, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor. Nga ana e AK. u kërkua shpallja e moskompetencës së kësaj gjykate për shqyrtimin e kësaj çështjeje, e cila nuk u pranua nga Gjykata. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përfundim vendosi: Pranimin e kërkesë-padisë. Kundër këtij vendimi, nga ana e AK-së është kryer ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila pranoi kërkesën e AK, për moskompetencën, duke i kaluar për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë dhe jemi në pritje të gjykimit nga kjo Gjykatë.
9. Çështja administrative me Paditës: Shoqëria “Landeslease” SHPK; i Paditur AK, Person i Tretë: Shoqëria “MUKA” SHPK; me objekt: “Shfuqizimi i Vendimit “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e qirasë financiare dhe në sektorin financiar” me nr. 412, datë 21.04.2016 i AK”. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pas shqyrtimit të kësaj çështjeje me vendimin nr. 3898, datë 21.07.2016 ka vendosur: Rrëzimin e Kërkesë-Padisë; duke lënë në fuqi vendimin e AK-së. Kundër këtij

vendimi, nga ana e ndërmarrjes është kryer ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.

### 3.4 Çështje në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Në Gjykatën e Lartë, gjatë vitit 2016 kanë qenë 11 çështje për shqyrtim, nga të cilat 4 janë shqyrtuar dhe mbeten 7, për t'u shqyrtuar në 2017.

1. Çështja administrative me Paditës: "Shoqëria "Romano-Port" SHA; i Paditur: AK, me Objekt: Anulim i pikave 1, 2 dhe 3 të vendimit nr. 221, datë 11.04.2012 të Komisionit të Konkurrencës. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 221, dt. 11.04.2012 të Komisionit të Konkurrencës deri në përfundim të gjykimit të çështjes. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10897, datë 14.11.2012 vendosi: "Pushimin e Gjykimit të kësaj çështjeje civile". Ky vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konfirmon ligjshmërinë e vendimit nr. 221, datë 11.04.2012 të Komisionit të Konkurrencës. Kundër këtij vendimi "Romano-Port" SHA, ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata e Apelit, Tiranë, në lidhje me këtë çështje shpalli moskompetencën lëndore në zbatim të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 dhe i kaloi për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit. Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë vendosi lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Kundër këtij vendimi paraqiti Rekurs në Gjykatën e Lartë, Paditësi, "ROMANO PORT" SHA, dhe Gjykata në përfundim vendosi: Mospranimin e Rekursit, duke lënë në fuqi përfundimisht vendimin e AK-së.
2. Çështja administrative me Paditës: Shoqëria "Alba Trans" SHPK; i Paditur: AK; me Objekt: Kundërshtim i vendimit 290, dt. 23.07.2013 të Komisionit të Konkurrencës, për pjesën që i takon Paditësit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, vendosi të pranojë padinë e kësaj ndërmarrjeje. Kundër këtij vendimi nga ana e AK-së është kryer ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata e Apelit Tiranë, në lidhje me këtë çështje shpalli moskompetencën lëndore në zbatim të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 dhe i kaloi për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit. Kjo e fundit vendosi: lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs Pala e Paditur, AK dhe jemi në pritje të caktimit të datës së Gjykimit.
3. Çështja administrative me Paditës: Shoqëria "NAZERI" SHRSF & "DEA" SHRSF; i Paditur: AK; me Objekt: Shfuqizim i vendimit nr. 240, datë 26.07.2012, i Komisionit të Konkurrencës. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi pranimin e padisë. Kundër këtij vendimi, nga ana e AK-së është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo e fundit, në lidhje me këtë çështje shpalli moskompetencën lëndore në zbatim të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 dhe i kaloi për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit. Kjo e fundit vendosi lënien në fuqi të

Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur Rekurs i Padituri, AK dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.

4. Çështja administrative me Paditës: “AMC” SHA; i Paditur: AK; me Objekt: Anulim i vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 26 – 27, datë 02.12.2005 dhe 12.12.2005. Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Lartë, pas Rekursit të paraqitur nga AK-ja, e cila pas shqyrtimit vendosi ta kthejë këtë çështje për rigjykim në Gjykatën e Apelit, Tiranë. Gjykata e Apelit, Tiranë në lidhje me këtë çështje shpalli moskompetencën lëndore, në zbatim të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 dhe i kaloi për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, e cila vendosi pranimin pjesërisht të padisë, duke pushuar gjykimin lidhur për vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 26, 02.10.2005 dhe duke pranuar padinë në lidhje me vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 27, 12.10.2005. Kundër këtij vendimi ka paraqitur Rekurs AK dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.
5. Çështja administrative me Paditës: “ARMO” SHA; i Paditur AK, me Objekt: Kundërshtimin e vendimit nr. 150, dt. 20.07.2010, të AK. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 2441, datë 17.10.2012 vendosi: “Lënien në Fuqi të vendimit nr. 5681, datë 28.06.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.” Kjo e fundit me vendimin nr. 5681, datë 28.06.2011 kishte vendosur: Pranimin e padisë dhe shfuqizimin e vendimit nr. 150, datë 20.07.2010 të Komisionit të Konkurrencës. Pra, edhe Gjykata e Apelit Tiranë, pavarësisht pretendimeve tona të parashtruara në ankim dhe në seancë gjyqësore, nuk e konfirmoi ligjshmërinë e vendimit nr. 150, datë 20.07.2012 të Komisionit të Konkurrencës. Kundër këtij vendimi AK-ja paraqiti Rekurs pranë Gjykatës së Lartë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.
6. Çështja administrative me Paditës: “Classic” dhe “Noti” SHPK, i Paditur AK, me Objekt: “Shfuqizimi i aktit administrativ, vendimi nr. 154 datë 01.10.2010 i Komisionit të Konkurrencës, lidhur me gjobën për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2096 datë 10.12.2012 vendosi: “Ndryshimin e vendimit nr. 3171, datë 03.04.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rrëzimin e padisë së ngritur nga “NOTI dhe CLASSIC” SHPK. Me anë të këtij vendimi Gjykata e Apelit Tiranë, në mënyrë përfundimtare, konfirmoi ligjshmërinë e vendimit nr. 154, datë 01.10.2010 të Komisionit të Konkurrencës. Kundër këtij vendimi, Paditësit paraqitën Rekurs pranë Gjykatës së Lartë, e cila në Dhomë Këshillimi, me vendimin nr. 228, datë 07.04.2016 vendosi: “Prishjen e vendimit nr. 2906, datë 10.12.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 3171, datë 03.04.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.
7. Çështja administrative me Paditës: “Atlas” SHA; i Paditur AK; Person i Tretë: “Bloja” SHA. Objekti: Shfuqizim i aktit administrativ, vendimit nr.125, datë 08.10.2009 të

Komisionit të Konkurrencës, në lidhje me konstatimin e marrëveshjes së ndaluar midis shoqërive "Bloja" SH.A dhe "Atlas" SHA. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. 979, datë 20.04.2012 vendosi: "Lënien në fuqi të vendimit nr. 359, datë 27.01.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 359, datë 27.01.2011 kishte vendosur për pranimin e padisë, duke e shfuqizuar vendimin nr. 125, datë 08.10.2009 të Komisionit të Konkurrencës, vetëm për pjesën që i përket "Atlas" SHA. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, AK paraqiti Rekurs pranë Gjykatës së Lartë, e cila me vendimin nr. 00-2016-213, datë 28.01.2016 vendosi: "Mospranimin e Rekursit".

8. Çështja administrative me Paditës: Shoqëria e Sigurimeve "INTERSIG-VIENNA INSURANCE GROUP" ShA; i Paditur AK, me Objekt: Shfuqizimin, anulimin e vendimit nr. 216, datë 01.03.2012 të Komisionit të Konkurrencës. Pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 11473, datë 23.11.2012 vendosi "Rrëzimin e kërkesës padisë". Me anë të këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, konfirmoi ligjshmërinë e vendimit nr. 216, datë 01.03.2012 të Komisionit të Konkurrencës. Kundër këtij vendimi, paditësi "INTERSIG" SHA paraqiti ankim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila pas shqyrtimit vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi, paraqiti Rekurs në Gjykatën e Lartë Pala Paditëse, "INTERSIG" SHA, e cila vendosi: "Mospranimin e rekursit", duke lënë në fuqi vendimin e AK.
9. Çështja administrative me Paditës: Shoqëria "Ferlut"; i Paditur AK, me Objekt: Kundërshtim i vendimit nr. 290, datë 23.07.2013 i Komisionit të Konkurrencës, për pjesën që i takon Paditësit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë vendosi: të pranojë padinë e kësaj ndërmarrjeje. Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur Rekurs i Padituri, AK dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.
10. Çështja administrative me Paditës: "Eurogjici Security" SHPK, "Eurogjici, Security 1" SHPK, "Toni Security" SHPK; I Paditur: AK; me Objekt: Kundërshtim i vendimit nr. 240, datë 26.07.2012 i Komisionit të Konkurrencës "Për vendosje gjobe". Secila nga palët paditëse, ka ngritur padi më vete kundër AK-së. Në lidhje me këto çështje Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi pranimin e padisë. Kundër këtij vendimi, nga ana e AK-së është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo e fundit, në lidhje me këtë çështje shpalli: moskompetencën lëndore në zbatim të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 dhe i kaloi për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, e cila me vendimin nr. 1400, datë 30.05.2016 vendosi: lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës

Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur Rekurs në Gjykatën e Lartë i Padituri, AK, dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.

11. Çështja administrative me Paditës: Shoqëria “Tirana Urban Trans”(TUT); i Padituri: AK, me Objekt: Kundërshtim i vendimit nr. 290, datë 23.07.2013 i Komisionit të Konkurrencës, për pjesën që i takon Paditësit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vendosi rrëzimin e padisë së ndërmarrjes, duke lënë në fuqi vendimin e AK-së. Kundër këtij vendimi, nga ana e ndërmarrjes është kryer ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. 554, datë 17.03.2016 vendosi: Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur Rekurs në Gjykatën e Lartë Paditësja, Shoqëria “Tirana Urban Trans” SHA, dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.

## PJESA E KATËRT

### ROLI I AUTORITETIT TË KONKURENCËS NË FORMULIMIN DHE IMPLEMENTIMIN E POLITIKAVE TË TJERA – ADVOKACIA E KONKURENCËS

#### 4.1 Vlerësimi i akteve dhe projekt-akteve normative.

Gjatë vitit 2016, AK ka marrë në shqyrtim dhe vlerësim, në përputhje me ligjin nr. 9121/2003, si me kërkesë të institucioneve propozuese apo edhe me nismën e vet, një sërë aktesh dhe projekt aktesh normative apo specifike, si në vijim:

1. Projektligji “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”. Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit nr. 406, datë 01.03.2016 “Për disa rekomandime mbi projektligjin “Kodi hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, i ka rekomanduar Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, implementimin në projektligjin në fjalë të shtesave vijuese:

Në nenin 42, pas pikës 3, të shtohet një pikë me këtë përmbajtje:

- a. “Autoriteti Rregullator Hekurudhor, para miratimit të çdo Marrëveshje/Kontrate koncensionare apo dhënies së të drejtave ekskluzive, merr paraprakisht edhe mendimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Në nenin 55 të bëhen shtesat e mëposhtme:

- b. Në pikën 2, të shtohet një paragraf me përmbajtjen: “Në rastet kur organi rregullator vëren shenja të një sjelljeje antikonkurrese nga sipërmarrësit hekurudhorë në tregjet e shërbimeve hekurudhore, e përcjell rastin pranë Autoritetit të Konkurrencës, duke i vënë në dispozicion gjithë informacionin përkatës.”

Në fund të pikës 10, të shtohet fjalia: “Në çdo rast organi rregullator njofton edhe Autoritetin e Konkurrencës.”

2. Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit””. Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 439, datë 20.10.2016 Për disa rekomandime mbi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, ‘Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit’”, i rekomandon Ministrisë së Financave që në atë projektligj: a) Në nenin 1, të shtohet përkufizimi mbi trajtimin e dëmit të ndodhur në Republikën e Shqipërisë, në mënyrë të drejtpërdrejtë nga siguruesi për të siguruarin, për të gjitha kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik; b) Në nenin 7, të hiqet pika 5, e cila parashikon hyrjen në fuqi të sistemit Bonus-Malus një vit pas

hyrjes në fuqi të ligjit, pasi ky sistem duhet të hyjë në fuqi njëkohshëm me vetë ligjin;

c) Në nenin 8, pika 2 të parashikohet zbatim i plotë i rekomandimit të AK-së për sigurimin e drejtpërdrejtë, për të gjitha dëmet e shkaktuara dhe jo vetëm për dëmet deri në 100.000 lekë.”.

3. Projektligji “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve””. Komisioni i Konkurrencës, me anë të vendimit nr. 442, datë 22.11.2016 “Për disa rekomandime mbi projektligjin e sipërcituar, i rekomandon Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe atij të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, që: Në projektligjin e sipërcituar, të shtohet një dispozitë në nenin 9 (ky i fundit bën ndryshimet në nenin 21 ekzistues të ligjit), ku të përcaktohet edhe bashkëpunimi i Agjencisë Kombëtare të Duhan Cigares (AKDC) me AK, në rastet kur agjencia dyshon për një sjellje të mundshme antikonkurruese të ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit.
4. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 ‘Për pronësinë industriale’”, (i ndryshuar). Lidhur me këtë projektligj, jemi shprehur se: Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9947, datë 07.07.2008 ‘Për pronësinë industriale’”, (i ndryshuar), nuk bie në kundërshtim me parimet dhe rregullat e konkurrencës.
5. Projektligji “Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre”, jemi shprehur dakord me dispozitat e projektligjit “Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre”, pasi nuk bien në kundërshtim me parimet dhe rregullat e konkurrencës, si dhe dispozitat e ligjit organik “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
6. Udhëzimi i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (MTI) “Mbi rregullat në vendosjen e tarifave të Aeroportit”. Nga vlerësimi ka rezultuar se ky udhëzim i MTI “Mbi rregullat në vendosjen e tarifave të Aeroportit” ka marrë në konsideratë rekomandimet e dhëna me anën e vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr.308, datë 21.02.2014 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të transportit ajror”, duke synuar rregullimin e tarifave aeroportuale, si dhe synon shmangien e çdo abuzimi të mundshëm me pozitën dominuese në tregun e shërbimeve aeroportuale nga entet menaxhuese të aeroportit. Përsa më sipër është vlerësuar se udhëzimi i MTI “Mbi rregullat në vendosjen e tarifave të Aeroportit” nuk bie ndesh me ligjin nr. 9121 /2003.
7. Autoriteti i Konkurrencës ka kryer edhe vlerësimin e dokumenteve të AKEP: “Analizë e Tregjeve me Shumicë të Aksesit Broadband në Internet dhe Linjave me Qira” dhe



"Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse - Këshillim Publik", dokumente, të cilat kanë adresuar drejt çështjet e konkurrencës, duke respektuar kriteret e ligjit nr. 9121/2003 në përcaktimin e operatorëve me FNT, në tregjet përkatëse.

8. Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të projekt/metodologjisë së tarifës fikse të energjisë elektrike, të prodhuar nga burime të ripërtëritshme, bazuar edhe në rekomandimet e mëparshme në lidhje me projektligjin "Për burimet e energjisë së rinovueshme" të dhëna nga Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, shkronjat (d) dhe (f), dhe nenit 70, të ligjit nr. 9121/2003, me vendimin nr. 408, datë 21.8.2016 i rekomandoi Entit Rregullator të Energjisë, të heqë nga projekt/metodologjia afatin 15-vjeçar të kontratave të shitjes së energjisë, si edhe çmimet fikse të shitjes së energjisë së ripërtëritshme.
9. Mbi rregulloren e "Procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga OSHEE SHA tek shoqëritë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike", Komisioni i Konkurrencës dha disa rekomandime me vendimin nr. 395, datë 26.01.2016 si vijon: "Procedura e blerjes, të kryhet në bazë të një platforme elektronike, e cila të marrë në konsideratë parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë të aktorëve të licencuar, për tregtimin e energjisë elektrike."  
AK-ja rekomandoi që projekt rregullorja e blerjes së energjisë elektrike, të përfshijë gjithë aktorët e tregut të energjisë elektrike, të cilët kryejnë blerjen e energjisë elektrike dhe jo vetëm OSHEE, si dhe procedura e blerjes së energjisë elektrike, të kryhet në bazë të një platforme elektronike, e cila të marrë në konsideratë parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë të aktorëve të licencuar, të shprehura edhe më parë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 334, datë 31.10.2014.
10. ERE gjatë vitit 2016, ka dërguar për opinion pranë AK-së projekt aktet nënligjore, në zbatim të ligjit nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe ligjit nr.138/213 "Për burimet e rinovueshme". Nga shqyrtimi i projektit të mësipërm, u konkludua se akti i paraqitur për opinion pranë AK-së, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003.
11. ERE njoftoi se në mbledhjen e bordit të komisionerëve të ERE-s, datë 31.03.2016 dhe vendimin nr. 36, datë 31.03.2016 u vendos "Miratimi i Certifikimit përfundimtar të TAP AG, si operator i pavarur i transmetimit të gazit natyror". Komisioni i Konkurrencës ishte shprehur edhe në vitin 2015, në lidhje me certifikimin e TAP AG, si operator i pavarur i transmetimit të gazit natyror.

12. ERE, me vendimin e datës 29.04.2016, miratoi fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e "Kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë", për të cilën ERE kërkoi opinionin e AK-së. Pas shqyrtimit të aktit të paraqitur, u konkludua se në parim ai nuk bie në kundërshtim me ligjin nr.9121/2003. Por, bazuar në faktin që furnizimi me energji elektrike është një e mirë publike, e domosdoshme dhe që ky shërbim ofrohet nga një operator i vetëm, me shkresën nr. 177/1, datë 01.06.2016, AK sugjeroi që në nenin 10.1, paragrafi i parë i draftit, të shtohet shprehja "[...] ka detyrim t'i dërgojë klientit fundor, në adresën e dhënë në kontratë faturën-tip të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit [...]".
13. ERE njoftoi AK edhe lidhur me projekt rregulloren "Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes". Për shqyrtimin e projekt rregullores së paraqitur, u kërkua informacion më i hollësishëm lidhur me mënyrën apo metodologjinë, e përcaktimit të tarifave në pjesën 4 të draftit përkatës. Në përfundim të shqyrtimit të aktit, u sugjerua të saktësohet neni 4.3, pika d, e cila përcakton ... "subjekti i autorizuar për kryerjen e punimeve...", si edhe saktësimi se te statusi i subjektit dhe te mënyra e përzgjedhjes së tij, të evidentohet përgjegjësia për cilësinë e punimeve dhe kostove që do të faturohen për shërbimin e kryer ndaj konsumatorëve ose përdoruesve të rrjetit, si dhe ndikimi i OSSH në këtë proces. Gjithashtu, me anë të një shkrese u sugjerua edhe parashikimi i mundësisë së përzgjedhjes nga ana e konsumatorëve/përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes e operatorit, i cili do të kryejë këtë shërbim.
14. ERE dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë iu drejtua AK për opinion në lidhje me projekt vendimin "Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike". Pas shqyrtimit të projekt vendimit Komisioni i Konkurrencës me shkresën 233/1 të datës 29.6.2016 u shpreh se drafti i paraqitur, në parim është shumë i rëndësishëm për tregun e energjisë, hapjen dhe liberalizimin e tij, konkretizimin me Bursën Shqiptare të Energjisë. Por, duke patur parasysh se drafti i paraqitur nuk i paraqet në mënyrë të qartë rolet, funksionet dhe mënyrën se si operatorët e tregut do të operojnë në treg dhe si rrjedhim, edhe efektet e konkurrencës në treg, Komisioni i Konkurrencës do të shprehet, pasi të qartësohet modeli përfundimtar i tregut.
15. ERE me vendimin nr. 117, datë 15.07.2016 "Për certifikim të operatorit të sistemit të transmetimit", filloi procedurat për shqyrtimin e aplikimit për të cilin kërkoi opinionin e AK-së. Nga shqyrtimi i aktit të paraqitur u konkludua se nuk bie në kundërshtim me ligjin nr.9121 /2003 dhe me anë të shkresës nr. 270/2 datë 08.08.2016 u theksua se konsiderohet shumë e rëndësishme për konkurrencën e tregut të energjisë elektrike, që aktorët e vetëm dhe të rëndësishëm të tregut (siç është OST), të operojnë në bazë të parimeve themelore të konkurrencës, që janë: mosdiskriminimi; trajtimi i barabartë; transparenca; si dhe tarifat e orientuara drejt kostos.

16. ERE me vendimin nr. 169, dt. 31.10.2016 "Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit, për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", filloi miratimin e procedurave për shqyrtimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s, nr.103, datë 23.06.2016. Pas shqyrtimit të aktit me ndryshimet përkatëse, AK vlerësoi se ndryshimet e propozuara në vendimin nr. 169, dt. 31.10.2016 nuk bien në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003. Përkundrazi, përdorimi i platformës elektronike për procedurat e prokurimit, do ta bënte procesin më konkurrues dhe më transparent.

#### **4.2 Rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës.**

1. Në tregun e prokurimit publik të shërbimit të konsulencës, Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit nr. 441, datë 22.11.2016 "Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e prokurimit publik të shërbimit të konsulencës", vendosi t'i rekomandojë Agjencisë së Prokurimit Publik, ndërmarrjen e nismave të nevojshme legislative për ndryshime në Dokumentet Standarde të Tenderit, si dhe për t'i propozuar Këshillit të Ministrave ndryshimet e mëposhtme, në VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik":
  - Rishikimin e sistemit të vlerësimit të ofertave për shërbimin e konsulencës, duke i dhënë prioritet kriterit që pasqyron cilësinë e eksperiencës në fushën objekt tenderimi, dhe/ose duke e përafruar edhe këtë pikë me legjislacionin e BE për prokurimet;
  - Rishikimin e kriterit mbi përvojën për punë të ngjashme të tre viteve të fundit, me qëllim rritjen e këtij afati dhe inkurajimin e shoqërive të reja për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik.
2. Në Tregun e qirasë financiare dhe sektorin financiar, Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit nr. 412, datë 21.04.2016 "Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e qirasë financiare dhe në sektorin financiar", vendosi për Shoqërinë "Landeslease" SHA:
  - detyrimin për ndryshimin e nenit 7, pika 4, të kontratës së qirasë financiare nr. 1464, nr. 339 rep., nr. 208 kol., datë 31.01.2015, duke i lënë "qiramarrësit" të drejtën e përzgjedhjes së ndërmarrjes siguroese, me qëllim sigurimin e automjetit objekt-kontrate me çmimin më të mirë të mundshëm.

- Njëpërmjet pikës II. të këtij vendimi, u vendos që: bankat e nivelit të dytë, ndërmjetësit financiarë dhe të gjitha shoqëritë e licencuara në sektorin financiar, kanë detyrimin t’u sigurojnë klientëve lirinë e zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit për çdo kontratë, duke hequr klauzolat e ekskluzivitetit apo ato përjashtuese në formën shkresore, por edhe në zbatimin real të tyre.
3. Në tregun e mediave-audiovizive, Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit nr. 429, datë 27.07.2016 “Për disa rekomandime dhe vlerësime ndaj Autoritetit të Mediave Audiovizive”, rekomandoi që: Në zonat gjeografike (nivel kombëtar, rajonal, lokal), të cilat përfshihen në përcaktimet e nenit 87 të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në RSH”, detyrimet e mbartjes të përmbushen sipas përcaktimit të këtij neni dhe rregullave të Autoritetit të Mediave Audiovizive për detyrimin e mbartjes.
- Një rekomandim tjetër është për palët e interesuara, që t’i drejtohen organit kompetent AMA, sipas përcaktimeve në ligjin nr.97/2013 për çështje që nuk kanë të bëjnë me mbrojtjen e konkurrencës, për sa i takon problematikave që lindin nga zbatimi i atij ligji.


Nga kjo analizë, mund të themi se nga 26 vlerësime që janë mbyllur në total për vitin objekt-raportimi, 15 prej tyre na janë adresuar nga vetë entet rregullatore apo të dala gjatë hetimeve/monitorimeve/përjashtime, të kryera nga ky institucion, mbi bazën e nenit 70 të ligjit organik nr.9121/2003. 7 janë marrë në konsideratë (1 prej tyre hap pas hapi) nga entet; 5 nuk janë marrë në konsideratë (nga të cilët njëri ankuar gjyqësisht dhe aktualisht, rekomandimi është lënë në fuqi nga gjykata); dhe 3 janë marrë në konsideratë, por procesi i miratimit të tyre ende nuk është mbyllur përfundimisht.

Pjesa tjetër e vlerësimeve prej 11 aktesh të AK-së janë projekt akte normative apo specifike, të sjella pranë AK nga organet e administratës qendrore dhe që janë vlerësuar nga ana e AK mbi bazën e nenit 69, të ligjit organik nr.9121/2003. Nga kjo shifër, 6 prej tyre janë marrë në konsideratë tërësisht; 1 prej tyre vetëm pjesërisht; 2 nuk janë marrë në konsideratë dhe 2 janë marrë fillimisht në konsideratë; por janë ende në procedura miratuese në Kuvend.

**Numri i rekomandimeve të dhëna mbi legjislacionin e tregjeve, mbi bazën e neneve 69; dhe/ose 70 të ligjit nr.9121/2003.**

**TABELA 10**

**Rekomandimet e dhëna sipas neneve 69 dhe 70**



**4.3 Transparenca dhe marrëdhëniet publike në funksion të advokacisë së ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Në zbatim të programit të transparencës, gjatë vitit 2016, AK ka realizuar:

- Zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit”.
- Zbatimin e ligjit “Për konsultimin Publik”.
- Konsultimin me median.

1. AK ka adresuar përgjigjet për të gjitha kërkesat për informacion sipas rregjistrimit të publikuar në faqen zyrtare të autoritetit. Gjatë vitit 2016, pranë AK-së janë depozituar 4 kërkesa, për të cilat është kthyer përgjigje në respektim të afateve kohore ligjore. Informacioni i kërkuar, lidhet me veprimtarinë e institucionit si dhe respektimin nga ana e institucionit të të gjitha kërkesave, lidhur me Programin e Transparencës në kuadër të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

2. AK në faqen zyrtare të saj ka publikuar të gjitha vendimet e Komisionit të Konkurrencës të marra gjatë 2016; formularët e ankesës, formularët e përqendrimeve , kërkesat për marrje informacioni, të cilat mund të plotësohen on-line nga ndërmarrjet ose konsumatorët.
3. AK ka shqyrtuar 11 raste të përqendrimeve, proces ky që është shoqëruar edhe me publikimin paraprakisht të informacionit mbi transaksionin, me ftesën që i bëhet palëve të interesuara të shprehin opinionet e tyre përpara vendimmarrjes së Komisionit. E njëjta procedurë është ndjekur edhe për raportet e monitorimit të tregjeve.
4. AK, gjatë vitit 2016 ka hartuara në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 9121/2003, 2 akte nënligjore, të cilat i ka publikuar në web-in e AK, për të marrë paraprakisht opinionet e palëve të interesit, kryesisht të shoqatave të biznesit, zyrave ligjore.
5. AK, boton “Buletinin e vendimeve të Komisionit të Konkurrencës” në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9121/2003, në faqen e web-it të institucionit, sëbashku me “Raporti Vjetor”.
6. Edhe gjatë vitit 2016, në respektim të dispozitave ligjore të ligjit nr.9121/2003, institucioni ka vijuar të përdorë të gjitha instrumentet e mundshme për të promovuar advokacinë e konkurrencës dhe për të forcuar kulturën e konkurrencës, fokusuar kjo në disa drejtime:
  - *Seminar Rajonal.* AK e vlerëson shumë të rëndësishëm bashkëpunimin me qeverisjen vendore, si dhe me komunitetin e biznesit. Me këtë synim, në bashkëpunim edhe me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë dhe universitetin “Aleksandër Moisiu” në qytetin e Durrësit, zhvilloi më datë 28 qershor 2016, tabelën e diskutimit për politikën kombëtare të konkurrencës dhe programin e ri të lehtësimit nga gjobat për biznesin, i cili synon bashkëpunimin me komunitetin e biznesit për zbulimin e praktikave anti-konkurrese.
  - *Dita Kombëtare e Konkurrencës,* 4 mars 2016. AK në bashkëpunim me studiot ligjore, organizoi një seminar në Tiranë me temë "Praktikat për njoftimin e përqendrimeve", që kishte në fokus të diskutimit rëndësinë e të dhënave dhe dokumenteve, që duhet të përfshihen në formularin për njoftimin e përqendrimeve, shqyrtimin e praktikave të përfunduara nga AK-ja, raste nga praktika të ngjashme.

## PJESA E PESTË

### INTEGRIMI EUROPIAN DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

#### 5.1 Integrimi europian

Procesi i Integritimit europian është një nga objektivat kombëtarë të vendit tonë. Pas marrjes së statusit të vendit kandidat, më 24 qershor 2014, në tetor 2016 Komisioni Europian depozitoi raportin pozitiv për Shqipërinë, ku iu propozua Këshillit Europian hapja e negociatave me vendin tonë. Në Progres Raportin e KE-së për vitin 2016, Kapitulli 8 ashtu si edhe në raportet e tjera periodike të KE-së është vlerësuar kontributi i AK-së, në drejtim të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, dhe respektimit të rregullave të konkurrencës.

AK-ja ka dhënë kontributin e saj në kuadër të raportimeve për Raportin e Progresit si dhe Planin Kombëtar të Integritimit Europian, duke udhëhequr kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës”.

Në takimin 8 të Nën-Komitetit BE-Shqipëri “Për tregun e brendshëm dhe konkurrencën, përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit”, të zhvilluar në datë 26 maj 2016 përfaqësuesit e DG Competition vlerësuan ndërhyrjet në treg, nëpërmjet rasteve hetimore dhe vendimmarrjen e Komisionit të Konkurrencës, rekomandimet e dhëna për institucionet qendrore e ato rregullatore, si dhe për përafrimin e legjislacionit. Përfaqësuesit e DG Competition, shprehën vlerësimet dhe konsideratat për punën dhe aktivitetin e institucionit, duke inkurajuar ndërhyrjet në tregje, në mbrojtje të konkurrencës së lirë.

#### 5.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar

*i. Veprimtaritë kryesore në kuadër të bashkëpunimit me UNCTAD.*

Asistenca e Konferencës së Kombeve të Bashkuar për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD) që i është ofruar gjatë vitit 2016 AK-së, ka konsistuar në kryerjen e trajnimeve të ndryshme në fushën e konkurrencës, me fokus jo vetëm stafin e AK-së por edhe sistemin gjyqësor, komunitetin e biznesit, si dhe përfaqësues të botës akademike.

Projekti i UNCTAD parashikon gjatë vitit 2017 aktivitete të tjera që do të forcojnë punën e AK-së, në veçanti realizimi i atyre aktivitete në mbështetje të rekomandimeve që janë theksuar edhe në dokumentin e *Peer Review (2015)*, i cili përcakton sfidat kryesore institucionale dhe ligjore që duhet të realizojë AK, në vite.

Në Kuadër të Rekomandimeve të KE<sup>7</sup>, nga AK në bashkëpunim me UNCTAD është siguruar dhe realizuar edhe trajnimi i sistemit gjyqësor shqiptar. Përgjatë vitit 2016, janë realizuar 2 seminare dyditore trajnimi, pranë Shkollës së Magjistraturës.

Në datat 21-22 prill 2016, u organizua në Tiranë një trajnim me gjyqtarët e Gjykatës së Administrative të shkallës së Parë dhe Apelit, si dhe të Gjykatave Civile lidhur me çështje të tilla si: standardi i provës në rastet e shqyrtimit gjyqësor të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës - *me fokus* – rishikimin gjyqësor të vendimeve të AK-së, për shkak të natyrës së rasteve të konkurrencës, analizave ekonomike të rasteve dhe domosdoshmërisë së njohjes së fushës së konkurrencës .

Më 29 - 30 qershor 2016, u organizua në Tiranë, trajnimi i dytë i radhës me gjyqtarët shqiptarë.

Ky seminar përmbylli ciklin e trajnimeve të organizuara për gjyqësorin - *me fokus* - rolin e gjyqësorit në fushën e konkurrencës, standardin e provës gjatë shqyrtimit të këtyre rasteve; natyrën e sanksioneve administrative/gjobat, si dhe njohja e metodologjisë që duhet zbatuar për përllogaritjen e tyre, në kuadër të zbatimit të rregullave të konkurrencës. Në seminar u soll edhe eksperiencia e vendeve anëtare të BE-së të tilla si Italia, Hungaria, Bullgaria dhe Çekia, kuadri ligjor dhe metodologjia që ato përdorin.

#### *ii. Bashkëpunimi me Sofia Competition Forum.*

AK është një nga shtetet pjesëmarrëse në Forumin e Konkurrencës së Sofjes (*Sofia Competition Forum - SCF*)<sup>8</sup>, i cili synon të nxisë bashkëpunimin dhe zhvillimin e lidhjeve rajonale në rajonin e Ballkanit, duke siguruar kështu një zbatim uniform të rregullave të konkurrencës. AK, luan një rol aktiv në këtë forum, jo vetëm nëpërmjet pjesëmarrjes aktive, diskutimeve dhe sjelljes së rasteve shqiptare, por edhe në dhënien e kontributeve dhe informacioneve sipas temave dhe çështjeve të ngritura.

Gjatë vitit 2016, Autoriteti Konkurrencës ka marrë pjesë në dy aktivitete të këtij forumi.

- Qershor 2016, ku u diskutuan çështje në lidhje me angazhimet e palëve në rastet e praktikave antikonkurrese si dhe kushtet dhe detyrimet në rastet e përqendrimeve;
- Nëntor 2016, ku u diskutuan çështjet në lidhje me abuzimin me pozitën dominuese në politikat e vendosjes së çmimeve, në sektorin e energjisë dhe telekomunikacionit.

Gjatë vitit 2016, institucioni ka dhënë kontributin e tij edhe në kuadër të hartimit të një pyetësoi krahasues midis vendeve anëtare, lidhur me procedurat që ndiqen për të pasur një proces të drejtë dhe objektiv, gjatë shqyrtimit të një rasti antikonkurrese.

<sup>7</sup> Dokument pune i stafit të Komisionit Europian; Raporti i vitit 2016 për Shqipërinë (Bruksel, 9.11.2016); Kapitulli 8 “Politika e Konkurrencës”, fq 48 (<http://www.integrimi.gov.al/al/dokumente/raportet-e-ke-per-shqiperine/raporti-i-ke-2016&page=1>)

<sup>8</sup> Në këtë Forum bëjnë pjesë Bullgaria, Unctad, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia dhe Serbia.



*iii. Bashkëpunimi me ICN (Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës).*

Në një ekonomi të globalizuar, një bashkëpunim ndërkombëtar i autoriteteve të konkurrencës, është element i rëndësishëm për forcimin e zbatueshmërinë së rregullave të konkurrencës. AK-ja, në këtë këndvështrim ka qenë një pjesëmarrës aktiv në ICN (*International Competition Network*), duke marrë pjesë në dy aktivitete të rëndësishme të zhvilluara:

- Workshop-in lidhur me praktikën kartel, ku u diskutua lidhur me mjetet e domosdoshme për zbulimin e marrëveshjeve të ndaluara dhe rëndësinë e bashkëpunimit midis autoriteteve për efektivitetin e zbulimit të këtyre praktikave, të mbajtur në datat 2-5 tetor ( Madrid);
- Workshop-in lidhur me hartimin e strategjive efektive për advokacinë e konkurrencës, të mbajtur në datat 3-4 nëntor (Meksikë).

### **5.3 Bashkëpunime dypalëshe**

AK i kushton rëndësi edhe bashkëpunimeve dypalëshe. Një bashkëpunim të tillë ka me Komisionin Kosovar të Konkurrencës, me të cilin ka zhvilluar edhe një aktivitet në 13 tetor 2016, ku është paraqitur eksperiencia dhe kuadri ligjor shqiptar dhe është diskutuar lidhur me asistencën që Shqipëria mund t'i ofrojë Komisionit Kosovar të Konkurrencës.



## PJESA E GJASHTË

### BURIMET NJERËZORE

#### 6.1 Struktura organizative e Autoritetit të Konkurrencës

Struktura Organizative e AK-së, e miratuar me vendimin të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nr. 77/2015, nuk ka patur ndryshime gjatë vitit 2016. Numri i punonjësve në total, për vitin 2016 është 37, nga të cilët 5 Komisionerë.

Një nga objektivat e vitit 2016 për AK-në, ka qenë forcimi i kapaciteteve administrative nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme për sigurimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Gjatë vitit 2016, stafi i AK-së ka marrë pjesë në seminare, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, trajnime dhe takime konsultuese në fusha të ndryshme që lidhen me politikën dhe ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, identifikimin dhe kufizimin e marrëveshjeve anti-kartel, abuzimin me pozitën dominuese, përqëndrimet, advokacinë e konkurrencës dhe vlerësimin ligjor.


Gjithashtu, bashkëpunimi me Shkollën e Administratës Shqiptare (ASPA) është realizuar në trajnimet për administratën publike, procedurat e prokurimit dhe menaxhimin e fondeve të BE-së, si dhe për programimin dhe implementimin e projektit IPA II.

#### 6.2 Të dhëna statistikore për trajnimin e stafit të AK-së

Pjesa më e madhe e trajnimeve është realizuar në legjislacion, ekonomi, administratë publike, ndërkohë që sipas fushave më specifike trajnimet janë kryer kryesisht në sektorin financiar, energji, telefoni dhe transport.


**Punonjës të trajnuar sipas tregjeve përkatëse për 2016**

**TABELA 11**



Ditë trajnimi sipas tregjeve përkatëse për 2016

TABELA 12



## PJESA E SHTATË

### OBJEKTIVAT DHE PËRAFRIMI INSTITUCIONAL ME STANDARTET DHE PRAKTIKAT E BE-së

#### 7.1 Objektivat e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2017.

- Autoriteti i Konkurrencës do të vazhdojë mbikëqyrjen e tregjeve për t'i bërë ato sa më konkurruese në një ekonomi funksionale tregu, me qëllim që të gjenerojë efekte pozitive për konsumatorët, biznesin dhe ekonominë në tërësi.
- Autoriteti i Konkurrencës do të thellojë veprimtarinë e tij në drejtim të përcaktimit sa më të qartë të rregullave të sjelljes së ndërmarrjeve në të gjitha tregjet dhe veçanërisht, në tregje si energjia, gazi dhe karburantet, shërbimet financiare, komunikimet elektronike dhe transporti, duke ndërhyrë rast pas rasti, për të rivendosur konkurrencën e lirë dhe efektive në treg.
- Autoriteti i Konkurrencës mbetet tërësisht i angazhuar për të mundësuar heqjen e barrierave dhe hyrjet e reja në tregje, dhe për të përdorur instrumente dhe të gjitha burimet në dispozicion: administrative, financiare dhe intelektuale për të luftuar monopolet dhe kartelet dhe për t'i dhënë frymëmarrjen e duhur biznesit të ndershëm dhe zhvillimit ekonomik të vendit.
- Autoriteti i Konkurrencës synon një bashkëpunimin në rritje me institucionet publike që u japin një/disa ndërmarrjeve, të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta, për të përmbushur detyrimin e nenit 69, të ligjit nr. 9121/2003 që të kërkojnë vlerësimin paraprak të AK-së, për çdo projekt akt normativ, që në mënyrë të veçantë ka të bëjë me vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të drejtave të veçanta, në zona të caktuara. AK do të vlerësojë shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës që rrjedh nga çdo projekt akt normativ dhe do të informojë rast pas rasti, institucionet që do të propozojnë këto akte dhe Kuvendin.

#### 7.2 Përafrimi institucional me standardet dhe praktikatat e BE-së.

Gjatë vitit 2017 AK do të:

- do t'i propozohet Kuvendit rishikimi i strukturës së Autoritetit të Konkurrencës me fokus rritja dhe forcimi i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore, me qëllim rritjen e cilësisë së monitorimit dhe inspektimit, hartimit të raporteve, cilësisë së mbrojtjes së vendimeve të Komisionit të Konkurrencës në proceset gjyqësore.
- do të ndërmarrë hapa konkretë në rishikimin e ligjit nr. 9121/2003, për një përafrim sa më të plotë me legjislacionin europian, si dhe hartimin dhe miratimin

e një kuadri ligjor sekondar, me qëllim zbatimin sa më efikas të legjislacionit në fushën e konkurrencës.

- do të draftohet dhe miratohet rregullorja: “Për kategoritë e marrëveshjeve të transfertave teknologjike”, e cila do të plotësojë kuadrin ligjor në fushën e konkurrencës si dhe do të parashikojë mënyrën se si kryhet procesi i vlerësimit për kategoritë e marrëveshjeve të transfertave teknologjike, nga ana e AK-së.
- do të vazhdojë të monitorojë rregullisht zbatimin e MSA-së, si pjesë përbërëse saj në Kapitullin e 8-të, si dhe të Planit Kombëtar për Integrimin Europian, duke dhënë kontributin përkatës për takimin e Nën-Komitetit të Tregut të Brendshëm dhe Konkurrencës.
- do të jetë përfitues i një projekti IPA II, me vlerë 700 000 euro, nëpërmjet të cilit synon të forcojë kapacitetet.
- Në kuadër të instrumentit të asistencës afatshkurtër *TAIEX*, pritet të realizohet gjatë 2017 forcimi i kapaciteteve të stafit, lidhur me analizat ligjore dhe analizat e mirëfillta ekonomike në shqyrtimin e rasteve të konkurrencës.
- Në kuadër të bashkëpunimit me UNCTAD, AK ka si objektivë të tij: një program të plotë trajnimi të stafit; ndërgjegjësimin e administratës publike qëndrore dhe vendore lidhur me detyrimin për të kërkuar mendimin dhe vlerësimin e AK-së në rastet e dhënies së të drejtave të veçanta dhe ekskluzive; zbatueshmërinë e Programit të Lehtësimit nga gjobat duke synuar rritjen e numrit të aplikimeve dhe ndërgjegjësimin për përftimet që vijnë nga ky program; organizimin e trajnimeve për sistemin gjyqësor; asistencë në rastet e vlerësimit dhe analizës së sektorëve të rëndësishëm të ekonomisë të tilla si tregu farmaceutik, tregu sigurimeve, tregu energjisë etj.
- Viti 2017 do të konsiderohet viti i transparencës dhe i vendosjes së urave të komunikimit me grupet e interesit dhe publikun, duke u fokusuar në marrëdhëniet me: median e shkruar dhe atë elektronike/gazetarët; dhomat e biznesit (tregtisë), Dhoma Amerikane e Tregtisë, dhe dhomat e tjera; institucionet rregullatorë dhe bizneset, të cilat duhet të pasqyrojnë në web- e tyre këshillimin me AK, rregullimet ligjore; publikun, për nxitjen e ndjeshmërisë ndaj funksionit; rolit të AK-së.

## ANEKSE

**Aneksi 1 – Të dhëna statistikore mbi vendimet e Komisionit të Konkurrencës sipas viteve.**

<b>Vendime Total 445</b>	<b>2004</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>	<b>2007</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>
<b>Vendime në total</b>	<b>13</b>	<b>17</b>	<b>14</b>	<b>25</b>	<b>29</b>	<b>36</b>	<b>34</b>	<b>43</b>	<b>48</b>	<b>42</b>	<b>42</b>	<b>51</b>	<b>52</b>
Përqëndrime	2	-	4	9	11	8	6	10	9	13	8	11	12
Abuzimin me pozitën dominuese				1	1	1	3	2	2	0	3	3	5
Marrëveshje të ndaluara				3		2	2	2	2	1	7	6	7
Përrjashtime nga marrëveshjet					1	1	-	-	1	1	1	1	4
Rregullore dhe udhëzues	6	2	-	4	4	2	7	6	5	3	2	3	5
Rekomandime ndaj institucioneve publike	1	3	1	2	5	10	5	5	5	1	4	11	12
Vendime për vendosje gjobe	-	1	1	5	-	2	2	1	7	2	2	0	0
Masa të përkohshme										1	0	1	0
Kushte dhe detyrime											1	2	1
Vendime të tjera	4	12	9	6	7	12	11	18	24	22	14	15	6

**Aneksi 2 - Sektorët e ekonomisë ku janë realizuar përqëndrimet për periudhën 2012-2016.**

<b>Tregu i produktit</b>	<b>Nr. i autorizimeve për (2012-2016)</b>	<b>Kompani të huaja</b>	<b>Kompani shqiptare</b>
Ndërtime	6	3	3
Tregu i lojërave të fatit, kazino elektronike etj.	3	1	2
Tregu i mjete motorike dhe pjesëve të këmbimit	2	1	1
Hoteleri turizëm	1		1
Veprimtari radio-televizive	1	1	
Tregti me pakicë ( cigare, industri ushqimi, produkte të përkujdesjes personale, produkte higjene etj.)	13	12	1
Tregu financiar	11	5	6
Hidrokarbure	5	4	1
Tregu i nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve	2	1	1
Infrastrukturë, Transport ajror	3	3	
Tregu i energjisë elektrike	3	2	1
Telekomunikacion	1		1
Transport detar kontejnerësh	1	1	
Pajisje elektronike dhe zgjidhje (solutions)	1	1	
<b>Totali</b>	<b>53</b>	<b>35</b>	<b>18</b>



### Aneksi 3 – Vendimet e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2016.

1. VENDIM nr. 395 , datë 26.01.2016 “Për disa sugjerime në lidhje me projekt-rregulloren e procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga OSHEE SH.A tek shoqëritë e licensuara për tregtimin e energjisë elektrike”
2. VENDIM nr. 396, datë 26.01.2016 “Për disa rekomandime mbi draft-kontratën konçesionare partneriteti publik privat e formës ROT “Për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e infrastrukturës hekurudhore Fier-Ballsh, Fier-Vlorë”
3. VENDIM nr. 397, datë 02.02.2016 “Për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”
4. VENDIM nr. 398, datë 09.02.2016 Mbi “Autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë SABMiller Plc. nga shoqëria Anheuser Busch InBev”
5. VENDIM nr. 399, datë 09.02.2016 Mbi “Autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë E.H.W. Sh.p.k. nga një ortak i vetëm”
6. VENDIM nr. 400, datë 10.02.2016 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e përpunimit dhe tregimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës”
7. VENDIM nr. 401, datë 23.02.2016 Për miratimin e Raportit Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2015 dhe synimet kryesore për vitin 2016”
8. VENDIM nr. 402, datë 23.02.2016 “Për dhënie vlerësimi mbi projekt/ligjin “Për mbrojtjen e sinjalizuesve”
9. VENDIM nr. 403 , datë 23.02.2016 “Mbi detyrimin e ndërmarrjes GFI Albania Sh.p.k për depozitimin e pasqyrave financiare të shoqërisë Petroleum Consulting Partners A.G ”
10. VENDIM nr. 404, datë 01.03.2016 “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.373, datë 16.09.2015 “Për hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në sektorin bankar”
11. VENDIM nr. 405, datë 01.03.2016 Për “Përfundimin e marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH dhe OSHEE, për tepricat e energjisë elektrike në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes deri në Qershor 2016”
12. VENDIM nr. 406, datë 01.03.2016 “Për disa rekomandime mbi projekt/ligjin “Kodi hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”
13. VENDIM nr. 407 , datë 08.03.2016 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ruajtje objektësh për vitin 2015”, ndarë në 13 lote, zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”

14. VENDIM nr. 408 , datë 21.03.2016 Për “Disa rekomandime për Entin Rregullator të Energjisë mbi draft metodologjinë e tarifës fikse të energjisë elektrike të prodhuar nga burime të rinovueshme”
15. VENDIM nr. 409, datë 21.03.2016 “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore” dhe dhënie rekomandimesh për Autoritetin Rrugor Shqiptar”.
16. VENDIM nr. 410, datë 31.03.2016 “Për administrimin e të dhënave elektronike gjatë inspektimeve nga Autoriteti i Konkurrencës.”
17. VENDIM nr. 411, datë 31.03.2016 “Për administrimin e sistemeve elektronike dhe bazave të të dhënave në Autoritetin e Konkurrencës”
18. VENDIM nr. 412, datë 21.04.2016 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e qerasë financiare dhe në sektorin financiar”
19. VENDIM nr. 413, datë 21.04.2016 “Mbi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij ndaj shoqërive “Lufra” Sh.p.k dhe “Erzeni” Sh.p.k”
20. VENDIM nr. 414, datë 04.05.2016 “Mbi autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të plotë indirekt nga shoqëria Geo-Jade Petroleum Corporation të shoqërisë Bankers Petroleum Ltd., nëpërmjet shoqërisë 1958082 Alberta Ltd
21. VENDIM nr. 415, datë 04.05.2016 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të produktit mjekësor “Lantus” (Insulinë)”
22. VENDIM nr. 416, datë 18.05.2016 “ Për disa rekomandime për rishikimin e tarifave dhe mbi hapjen e tregut të shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve.”
23. VENDIM nr. 417, datë 18.05.2016 “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar “Tirana International Aeroport”
24. VENDIM nr. 418, datë 30.05.2016 “Për disa rekomandime mbi vendimin e Këshillit Administrativ të FSDKSH-së mbi kriteret që duhet të plotësojnë farmacitë dhe agjencitë farmaceutike për lidhjen e kontratave me Fondin”
25. VENDIM nr. 419, datë 08.06.2016 PËR MIRATIMIN E UDHËZIMIT “MBI PROCEDURAT E THJESHTUARA PËR TRAJTIMIN E DISA PËRQËNDRIMEVE”
26. VENDIM nr. 420, datë 08.06.2016 Mbi “Autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit shoqërisë Tirana International Airport Sh.p.k nga Keen Dynamics Limited”
27. VENDIM nr. 421, datë 22.06.2016 Mbi “Autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Asahi Group Holdings Ltd. të biznesit të birrës të zotëruar nga SABMiller Plc.”

28. VENDIM nr. 422, datë 22.06.2016 Mbi "Autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Veneto Banca S.p.A nga Quaestio Capital Management SGR S.p.A nëpërmjet fondit Atlante"
29. VENDIM nr. 423, datë 29.06.2016 "Për shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes LANDESLEASE SHA për revokim të Vendimit nr. 412, datë 21.04.2016 të Komisionit të Konkurrencës"
30. VENDIM nr. 424 , datë 29.06.2016 "Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit"
31. VENDIM Nr. 425 , datë 14.07.2016 Mbi "Autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të tërthortë të shoqërisë A4 Holding S.p.A nga Abertis Infraestructuras S.A"
32. VENDIM nr. 426, datë 20.07.2016 Mbi "Autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Eurosig SH.A të shoqërisë Insig SH.A"
33. VENDIM nr. 427, datë 20.07.2016 Mbi "Autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Novamatic Gaming Industries GmbH të 100% të kapitalit të shoqërisë Albanisch Österreichische Holding Gesellschaft m.b.H"
34. VENDIM nr. 428, datë 27.07.2016 "Për përjashtimin individual nga ndalimi të Marrëveshjes-Tip "DIGITALB - OPERATOR TELEVIZIV"
35. VENDIM nr. 429, datë 27.07.2016 "Për disa rekomandime dhe vlerësime ndaj Autoritetit të Mediave Audiovizive"
36. VENDIM nr. 430, datë 07.09.2016 "Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme)"
37. VENDIM nr. 431, datë 14.09.2016 Mbi "Autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Eurokontakt Sh.p.k të 100% të kapitalit të shoqërisë Lion Real Estate Albania Sh.p.k"
38. VENDIM nr. 432, datë 14.09.2016 Mbi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar "Tirana International Aeroport"
39. VENDIM nr. 432/1 , datë 14.09.2016 "Për një ndryshim në Vendimin nr. 432, datë 14.09.2016"
40. VENDIM nr. 433 , datë 21.09.2016 Mbi "Autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria GMBF Investment S.a.r.l të shoqërive NV Biscuits Delacre SA dhe United Biscuits Industries SAS nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve"
41. VENDIM nr. 434, datë 21.09.2016 "Për përjashtimin e marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH dhe OSHEE, për tepricat e energjisë elektrike"

në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën 1 Korrik 2016 deri Dhjetor”

42. VENDIM nr. 435, datë 21.09.2016 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme)”

43. VENDIM nr. 436, datë 27.09.2016 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 428, datë 27.07.2016 “Për përjashtimin individual nga ndalimi të Marrëveshjes -Tip “DIGITALB - OPERATOR TELEVIZIV”

44. VENDIM nr. 437, datë 05.10.2016 Për miratimin e rregullores “ Mbi procedurat e angazhimeve ”

45. VENDIM nr. 438, datë 05.10.2016 “Mbi disa rekomandime dhe mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit”

46. VENDIM nr. 439, datë 20.10.2016 Për “Disa rekomandime mbi projekt/ligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", të ridërguar.

47. VENDIM nr. 440 , datë 10.11.2016 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të produktit mjekësor “Lantus” (Insulinë)”

48. VENDIM nr. 441, datë 22.11.2016 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e prokurimit publik të shërbimit të konsulencës”

49. VENDIM nr. 442, datë 22.11.2016 “Për disa rekomandime mbi projekt/ligjin “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, të ndryshuar”

50. VENDIM nr. 443, datë 30.11.2016 “Për masat dhe detyrime për ndërmarrjet e sigurimit dhe disa rekomandime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare mbi rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”

51. VENDIM nr. 444, datë 30.11.2016 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e përpunimit dhe tregimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij ndaj shoqërive “Lufra” Sh.p.k dhe “Erzeni” Sh.p.k dhe dhënien e rekomandimeve për rritjen e konkurrencës në tregun përkatës”

52. VENDIM nr. 445, datë 13.12.2016 Mbi “Autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Fondi BESA SH.A. të shoqërisë VisionFund Albania Sh.p.k”

**Aneksi 4 – Buxheti faktik i Autoritetit të Konkurrencës viti 2016.**

<b>E m ë r t i m i</b>	<b>Njësia</b>	<b>Plan</b>	<b>Fakt</b>	<b>Diferenca</b>	<b>Realizimi</b>
Paga, shpërblime, shpenzime etj.	<i>lekë</i>	45 500 000	45 344 000	156000	99.7%
Kontribute për Sig. Shoqërore	<i>lekë</i>	7 000 000	6 729 000	271 000	96.1%
Materiale dhe Shërbime	<i>lekë</i>	10 300 000	8 587 000	873 000	91.1%
Investime	<i>lekë</i>	1 000 000	681 000	319 000	68.1%
<b>Totali</b>	<b><i>lekë</i></b>	<b>63 800 000</b>	<b>61 661 000</b>	<b>1 619 000</b>	<b>97.4 %</b>

**Aneksi 5 - Të ardhura nga përqendrimet shkuar në Buxhetin e Shtetit.**

<b>E m ë r t i m i</b>	<b>Njësia</b>	<b>Totali i Arkëtuar</b>
<b>Të ardhura nga përqendrimet</b>	<b><i>lekë</i></b>	<b>6 505 000</b>